

**T**evekkuli

**N**ga dija te tevekkuli

**A**jete dhe hadithe

**P**aracaktimi hyjnor dhe enigmat e tij

**V**ahshiu

**R**elikte historike

**A**ktualitet



*Mbështetu te  
Allahu*



## EDITORIAL

### **I dashur lexues!**

Tevekkuli ose mbështetja tek Allahu është një ndër konceptet më të rëndësishme të besimit islam dhe burimi i tij është Kur'ani dhe mësimet profetike.

Tevekkul do të thotë që njeriu të jetë i kënaqur me çdo gjë që vjen nga Zoti. Tevekkul do të thotë që njeriu të mos i japë më shumë rëndësi vullnetit të tij dhe ligjeve të natyrës se sa vullnetit të Allahut, sepse sa më shumë rëndësi tu japë shkaqeve dhe ligjeve natyrore, aq më pak i jep rëndësi vullnetit hyjnor. Me një thënie tjetër, tevekkuli është mbështetja te Allahu dhe lënia e çështjes në dorën e Tij, pasi nuk ka ngelur gjë tjetër për t'u bërë në mëyrë që të arrijmë synimin tonë. Në ajete dhe hadithe shprehet qartë se tevekkuli do të thotë t'a lësh në dorë të Allahut një çështje, pasi janë marrë të gjitha masat për realizimin e saj. Siç thuhet në ajetin kur'anor:

**“Kur të vendosësh, atëherë mbështetu te Allahu!”** (Ali Imran, 159) dhe në hadithin profetik: “Sikur t'i mbështeteni Allahut ashtu siç duhet, Ai do t'ju furnizojë siç furnizon zogjtë. A nuk e shikoni se zogu del në mëngjes i uritur nga foleja dhe kthehet në mbrëmje i ngopur?” (Ibn Maxhe, Zuhd, 14)

Për tevekkul së pari duhet vepra. Duhet t'i përmbushim detyrat tona si njerëz, të mendojmë anën pozitive dhe negative të veprimeve dhe të këshillohemi me të tjerët. Pastaj, kur të marrim një vendim, atëherë duhet t'i mbështetemi Allahut pa pasur dyshimin më të vogël tek e vërteta se çdo gjë është në dorën e Tij...

Lexim të këndshëm!



NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI:

4



KUR NUK KA MBETUR TJETËR ZGJIDHJE

*HASAN KAMIL JËLLMAZ*

4

TEVEKKULI

*SADIK DANA*

8

NGA DIJA TE TEVEKKULI

*RIFAT KANDEMOGLU*

12

TEVEKKULI NË ALLAHUN (XH.SH.)

*DR. RIJAD EL MUSJEMIR*

16

MBËSHTETJA NË ALLAHUN (XH.SH.)

*NAIM DRIJAJ*

20

DISA ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME MBI TEVEKKULIN

*EVANS DRISHTI*

22

JAM MBËSHTETUR TE ALLAHU

*DR. SEID ABDULAZIM*

26

AJETE DHE HADITHE

30

PARAKTIMI HYJNOR DHE ENIGMAT E TIJ

*OSMAN NURI TOPBASH*

32

12



32



# Mars - Prill 2009

## LEHTËSIA E MBËSHTETJES NË ALLAHUN (XH.SH.)

*HARUN JAHJA*

38

## QËNDRIMI I DIJETARËVE RRETH FESTIMIT TË DITËLINDJES SË PEJGAMBERIT A.S.

*MR. FLAMUR SOFIU*

42

VAHSHIU

*ALI VEZAJ*

48

## RELIKTE HISTORIKE

*ZYMER RAMADANI*

50

## PREZANTIM LIBRI

*EVANS DRISHTI*

54

## SHËNDETI DHE FAMILJA

*ALI ILJAZI*

56

## TEKNOLOGJ

*ALI BARDHI*

58

## AKTUALITET

59

38



42



48



Viti: III Numri: 17

- Mars - Prill 2009
- Sefer - Rebiul evvel 1430

Boton

- Progresi sh.p.k.
- Shkodër / Shqipëri

Përkthyes

- Ataullah Aliu
- Ermal Nurja
- Evans Drishti
- Fatmir Sulaj
- Lavdrim Hamja

Redaktor

- Islam Dizdari

Dizenjo - Grafik

- Bledar Xama
- [bledar\\_xama@hotmail.com](mailto:bledar_xama@hotmail.com)

Ngjyra

- Progresi

Adresa

- L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
- Shkodër
- Tel: +355 20 76768 / +355 20 86767

Shtyp

- ArbëriaDesign, Tetovë
- Tel: +389 44 35 33 71
- Fax: +389 44 35 33 72

Për artikuj

- e-mail: [revistaetika@hotmail.com](mailto:revistaetika@hotmail.com)
- e-mail: [etikaeditor@yahoo.com](mailto:etikaeditor@yahoo.com)

Çmimi

- 1 Euro
- 150 Lek
- 60 DEN



# Kur nuk ka mbetur tjetër zgjidhje...



Tevekkuli është një koncept kuranor dhe një shprehje mistike. (Shik. Ragib Isfihani, Mufredat. Fq. 834; Ibnu'l-Esir, en-Nihaje, V, 221)



*"Sikur t'i mbështeteni Allahut ashtu siç duhet, Ai do t'ju furnizonte ju siç furnizon zogjtë. A nuk e shikoni se zogjtë dalin në mëngjes të uritur nga foletë e tyre dhe kthehen në mbrëmje të ngopur?"*

(Ibn Maxhe, Zuhd, 14)



Tevekkuli është besimi i njeriut ndaj Allahut dhe të kënaqurit e tij me çdo gjë që i vjen nga Ai pasi veprat e tij t'i bëjë sipas rregullit Zot-nënshtuar. Tevekkuli është që njeriu të mos i japë më shumë rëndësi vullnetit të tij dhe ligjeve të natyrës se sa vullnetit të Allahut pa i bërë idhuj shkaqet dhe masat paraprake, sepse sa më shumë rëndësi t'u japë shkaqeve dhe ligjeve natyrore, aq më pak i jep rëndësi vullnetit hyjnor. Me një thënie tjetër tevekkuli është mbështetja te Allahu dhe lënia e çështjes në dorën e Tij pasi nuk ka ngehur gjë tjetër për t'u bërë që të arrihet qëllimi. Në ajete dhe hadithe shprehet qartë se tevekkuli do të thotë që t'ia lësh në dorë Allahut një çështje pasi janë marrë të gjitha masat njerëzore. Siç thuhet në ajetin kuranor:

**"O i dashuri im, fali ata, kërko falje për ta! Konsultohu me ta në të gjitha çështjet! Kur të vendosësh, atëherë**

**mbështetu te Allahu!"** (Ali imran, 159) edhe në hadithin fisnik thuhet: *"Sikur t'i mbështeteni Allahut ashtu siç duhet, Ai do t'ju furnizonte ju siç furnizon zogjtë. A nuk e shikoni se zogjtë dalin në mëngjes të uritur nga foletë e tyre dhe kthehen në mbrëmje të ngopur?"* (Ibn Maxhe, Zuhd, 14)

Në këtë ajete dhe hadith fisnik shprehet shumë qartë se tevekkuli bëhet pasi t'i kryesh shkaqet që shikohen dhe dihen. Shkaku i furnizimit të zogjve nuk është qëndrimi në fole por dalja nga foletë e tyre për të kërkuar riskun.

Për tevekkul së pari duhet vepra. Duhet t'i kryejmë masat, të mendojmë anën pozitive dhe negative dhe të konsultohemi. Pastaj, kur të vendosim, duhet t'i mbështetemi Allahut pa dyshuar dhe u shqetësuar. Për shembull, nëse një bujk kujdeset shumë për tokën e tij, e punon, e mbjell, e ujit, e prashit, i hedh pleh në kohë,

e pret rezultatin e këtyre nga Allahu dhe nuk bazohet në masat dhe gjërat që ka bërë, ai ka bërë një tevekkul të plotë. Por, nëse nuk i bën këto, është gabim të flasim për tevekkulin. Hz. Mevlana thotë:

Eja dhe bëj tevekkul, duke punuar gjithmonë

Së pari mbille farën, pastaj kërko nga Allahu!

Tevekkuli është shoku i besimit dhe veçoria më e rëndësishme e besimtarit të vërtetë. Allahu (xh.sh.) në shumë ajete të Kur'anit e ka cilësuar tevekkulin si veçori e besimtarëve. Për shkak se tevekkuli është një rrugë lumturie që i jep qetësi dhe prehje zemrës, i Dërguari i Allahut a.s. në lutjet e tij thotë:

*“O Zot! Ty të jam dorëzuar. Ty të besoj dhe te Ti bëj tevekkul (mbështetem).”* (Buhari, Deavat, 9)

Për shkak se besimin ndaj vetes, qoftë edhe sa hap e mbyll



***“O i dashuri im, fali ata, kërko falje për ta!  
Konsultohu me ta në të gjitha çështjet! Kur të  
vendosësh, atëherë mbështetu te Allahu!”***

(Ali imran, 159)



sytë e ka cilësuar si një humbje për njeriun, thotë: *“O Zot! Mos më lër mua në dorë të vetes sime në një kohë sa hap e mbyll sytë, madje as në një kohë edhe më të shkurtër se ajo!”* (Shik. Ebu Davud, Xhihad, 35)


Tevekkuli është burimi më i madh i forcës për njerëzit në punët e tyre. Është mbështetja më e madhe që njeriu të mos lëkundet në betejën e jetës. Është burim kuraje dhe shkak për sukses në gjendjet më të vështira dhe në momentet e

dobësisë. Allahu në Kur'an thotë:

***“Sa e sa grupe të vogla me lejen e Allahut kanë triumfuar ndaj grupeve të mëdha!”*** (el-Bekara, 249) Ajo që u dha sukses atyre janë përpjekjet e tyre të sinqerta, tevekkulet e mbështetjet që kishin te Allahu dhe besimi që kishin te ndihma e Tij.


Në misticizëm që nga fillimi tevekkuli është parë si një çështje zemre dhe gjithmonë është komentuar si besim dhe





**“O Zot! Mos më  
lër mua në dorë  
të vetes sime në  
një kohë sa hap e  
mbyll sytë, madje  
as në një kohë edhe  
më të shkurtër se  
ajo!”**

(Shik. Ebu Davud, Xhihad, 35)



mbështetje ndaj Allahut. Po ashtu këtë mund ta shikojmë edhe në përkufizimet e mistikëve të parë. Ebu Turab Nahshebi thotë: “Tevekkuli është lidhja e zemrës me rububijetin duke e hedhur trupin në adhurim.” Ndërkohë që Zunun thotë: “Tevekkul do të thotë të mos u besosh masave të vetes dhe të mos shikosh në vete ndonjë forcë apo fuqi”, Xhunejdi thotë: “Tevekkuli është besim dhe mbështetje te Allahu në çdo lloj gjendjeje.” Ibn Xhella: “Tevekkuli është strehim te Allahu.” Ruvejmi e përkufizon: “Besim ndaj premtimit hyjnor.” Edhe pse në çështjen e tevekkulit përkufizimet janë bërë në këtë drejtim, nga mistikët asketë kanë dalë edhe disa që ndjekin një rrugë që mund të thuhet se e kanë ekzagjeruar. Siç kanë dalë disa që mjekimin e

sëmundjes e kanë cilësuar si diçka që e kundërshton tevekkulin, po ashtu ka edhe prej atyre që e kanë hedhur poshtë marrjen e masave. Ky koncept më shumë do të thotë “mosbesim ndaj masave”. Mistikët e Horosanit zakonisht janë cilësuar si “njerëzit e tevekkulit”. Më kryesorët e tyre janë Ibrahim Ed’hemi, Shakik Belhi dhe Fudajl bin Ijad.

Sehl bin Abdullah Tusteri ka një komentim interesant që e komprometon tevekkulin me punën. Sipas tij tevekkuli është gjendje e të Dërguarit të Allahut ndërsa fitimi duke punuar (kesb) është syneti i tij. I Dërguari i Allahut ua ka mësuar rrugën e fitimit njerëzve për shkak të dobësive që burojnë nga dijet e tyre të mangëta ashtu që, nëse bien nga shkalla e tevekkulit e cila është gjendja e tij, të paktën të mos bien nga suneti i tij. Ai që i del kundra fitimit duke punuar, i ka dalë kundra sunetit, ai që i del kundra tevekkulit, i ka dalë kundra përcaktimit dhe besimit.

Ashtu siç thotë Sehli edhe mistikët e tjerë kanë bërë një lidhje ndërmjet kesbit dhe tevekkulit. Ata kanë shprehur se në një kohë kur tevekkuli të jetë i saktë, nuk ka ndonjë gjë kundra tij nëse mbart ushqim apo përpiqesh për ta siguruar atë. Ndërsa një grup tjetër prej mistikëve ushqimin e tyre e kanë lidhur vetëm me kesbin dhe u kanë dalë kundra atyre që nuk preokupohen me kesbin si ata që i mbështeten kesbit. Këta përmirësimin e gjendjes e kanë lidhur vetëm

me pastërtinë e ushqimit, ndërsa pastërtinë e ushqimit e kanë lidhur me fitimin. Ata kanë marrë si argument për këtë edhe hadithin: “Gjëja më e pastër që kanë besimtarët, është munda i dorës së tyre.” (Keshfu’l-hafa I, 58), sepse kesbi është një leje për ata që nuk kanë fuqi të mjaftueshme për tevekkulin. Ai është mosmbështetja ndaj kesbit, mospandehja se risku vjen nga kesbi, puna me nijet për të ndihmuar myslimanët dhe jo për të fituar ndonjë mirësi apo për të mbledhur mall. Puna dhe kesbi nuk duhet të jenë pengesë për farzet dhe rrugë për haramin. Njeriun e shpëton dija e tij nga fikhu që të mos bie në këtë gabim.

Ebu Nasr Serraxh ka tërhequr vërejtjen se tevekkuli i vërtetë nuk është larg ndërmjetësismit ndajshkaqeve duke thënë: “Disa njerëz kanë gabuar se tevekkuli i vërtetë është dalja nëpër luginë dhe shkretëtira pa ushqime, pa ujë dhe pa materiale. Në të vërtetë këtë fakt e vërteton i Dërguari i Allahut i cili i tha atij që e kishte lënë devenë të lirë dhe që tha se i ishte mbështetur Allahut: “Së pari lidhe devenë, pastaj mbështetu Allahut!” (Tirmidhi, Kijame, 60) dhe Hz. Omer i cili u doli kundra dhe iu përgjigj disave të cilët prisnin risk pa bërë asnjë punë dhe të cilët i cilësonin vetët e tyre si “mutevekkil” (njeri që i mbështetet Allahut) duke u thënë: “Ju nuk jeni mutevekkila, por muteek-kila (armiq njerëzish)”.

Gazzali e studion tevekkulin me tre dimensione si dije, gjendje dhe vepër. Dimensio- ni i dijes për tevekkulin është vërtetim me zemër, dimensio-

ni i gjendjes është nënshtrim dhe mbështetje, ndërsa vep-  
ra është një akt që e kërkojnë  
kushtet normale.

Tevekkuli si një çështje zem-  
re dhe ndjenjë besimi realizo-  
het në tre shkallë:

1. T'i mbështetet robi Alla-  
hut siç i mbështetet kujdesta-  
rit të tij,

2. T'i drejtohet robi vetëm  
Allahut si fëmija që nuk njih  
askënd përveç nënës së tij,

3. T'i dorëzohet robi Allahut  
si gjetnja përpara erës.

Ka edhe prej atyre që e kup-  
tojnë tevekkulin në formë tre-  
she bashkë me teslimin (nën-  
shtrimin) dhe tefvizin (dhënie  
e një punë dikujt tjetri). Tevek-  
kuli është besim ndaj prem-  
timit të Allahut, teslimi është  
besim ndaj dijës së Allahut  
dhe nënshtrim ndaj Tij duke e  
ditur se Allahu e di atë, ndër-  
sa tefviz është pranim i ligjit të  
Allahut. Kuptimi vetëm si be-  
sim dhe mbështetje e dimen-

sionit të masave të tevekkulit  
është bërë shkak për shumë  
humbje materiale dhe shpirt-  
ërore. M. Akif këtë gjendje e  
shpreh kështu:

Ndërkohë që sheriatu thotë  
puno, ti nuk punove,

Për të shpif shumë besëtyt-  
ni.

Më së fundi fute një tevek-  
kul

Dhe me të e ktheve fenë e  
shkretë në diçka qesharake.

Nuk ngrihesh nga krevati  
duke thënë se i mbështetem  
Allahut,

A ky është kuptimi i tevek-  
kulit o i paedukatë?

E bërë Zotin rob,

A tevekkul i thuaj ti kësaj  
paturpësie?

Poeti i njohur i cili rënie  
dhe shpërndarjen tonë si  
bashkësi fetare e lidh me de-  
mbelizmin dhe neglizhimin  
ndaj fesë sonë, shprehet se

një tevekkul i cili kuptohet  
gabim në këtë mënyrë mund  
ta shpjerë njeriun në shirk.  
Konceptimi i tevekkulit në  
kuptim të një paaftësie të tillë  
në dritën e ajeteve dhe hadi-  
theve nuk është as prej Islamit  
dhe as prej misticizmit. Madje  
siç pandehet edhe vendet ku  
kuvendojnë dijetarët mistikë  
nuk janë vende për të ngrënë  
ata të cilët bëjnë tevekkul prej  
përtacisë. Po, në vendet ku  
kuvendojnë dijetarët mistikë  
ka dhoma për ta. Bëhej supë,  
por në këto dhoma kishte di-  
jetarë që bënin çile (edukim  
i vetes me adhurim duke u  
mbyllur në një vend) në një  
kohë të caktuar deri në dyzet  
ditë. Ose dervishët që bënin  
shërbim, qëndronin aty. Nga  
supa që bëhej mund të hante  
çdokush që vinte dhe kalonte  
aty.





# Tevekkuli

*“Vallë a ka ndonjë prej jush që ka ngrënë një kafshatë ushqim duke iu mbështetur vetëm Allahut Teala pa u mbështetur dhe pa i besuar vetes apo njerëzve të tjerë?”*

Tevekkul do të thotë t’i besosh dhe t’i mbështetesh Allahut plotësisht në çdo punë dhe çështje. Vendi i tevekkulit është zemra. Domethënë tevekkuli është një çështje zemre.

Të marrësh masa, në pamjen e jashtme, nuk është pengesë për tevekkulin e zemrës. Përcaktimi është nga Allahu Teala. Nëse një çështje vështirësohet, përsëri kjo është me përcaktimin e Allahut. Të gjithë robërit vetëm Allahun duhet ta njohin si e vetmja qenie që adhurohet. T’i besojnë dhe t’i mbështeten plotësisht Atij. Mbështetja dhe tevekkuli ndaj pasurisë, detyrës, mendjes, pozitës dhe fëmijëve nuk jep gjithmonë rezultate të mira, sepse edhe këta kanë nevojë për Allahun i cili i ka krijuar dhe u jep riskun. Në hadithin fisnik transmetohet:

“-Në tokë nuk ka asnjë të mbjellë apo fryt të pjekur nëpër pemë që mbi të të mos jetë e shkruar **‘Bismillahirrahmanirrahim, ky është risku i filanit të birit të filanit’**”.

Tevekkuli i vërtetë është mbështetje vetëm te Allahu duke e hedhur frikën dhe shpresën nga çdo gjë. Tevek-

kuli i vërtetë është që robi, pasi të marrë masat, të lërë çdo lloj shkak dhe të mbytet në detin e shikimit të poseduesit të vërtetë të shkaqeve.

## RISKU DHE TEVEKKULI

H. Shah Suxha Kirmani kishte një vajzë. Padishahu i Kirmanit dëshiroi të martojë me të.

Ai i tha: “Më jepni tre ditë leje, pastaj do të të përgjigjem.” Pastaj shehu shkoi xhami më xhami dhe nëpër vendet ku mblihdeshin dijetarët për të gjetur një dijetar që t’i jepte vajzën. Në xhami pa një djalë që po falte namaz. Kur e mbaroi namazin, Shehu e pyeti:

-O bir, a ke shtëpi?

-Jo.

-A mund të martohesh me një vajzë?

-Kush më jep mua vajzë, kam vetëm tre akça (para prej argjendi).

*“Në tokë nuk ka asnjë të mbjellë apo fryt të pjekur nëpër pemë që mbi të të mos jetë e shkruar **‘Bismillahi - rrahmanirrahim, ky është risku i filanit të birit të filanit’**”*

-Njërën prej tre akçave harxhoje për bukë, tjetrën për mish dhe tjetrën që ngeli për karrota.

Dhe ia dha vajzën atij. Po atë natë ia dorëzoi. Vajza e Shehut shkoi në shtëpinë e djalit. Kur pa se mbi gotë kishte një copë bukë të thatë, pyeti:

-Ç' është kjo bukë? Djali u përgjigj:

-Ka ngelur që mbrëmë. Vajza tha:

-Allahu që dha riskun e djeshëm a nuk jep edhe sot që e ke lënë gjysmën e saj për nesër? Babai më tha se më ka dhënë te një njeri që i mbështetet Allahut. Por më paska dhënë te një njeri që nuk i besuaka Allahut për riskun.

Hamdun Kassar e përkufizon kështu tevekkulin:

-Tevekkul do të thotë, nëse ke një dirhem borxh dhe në xhep nuk ke asnjë qindarkë, të mos e presësh shpresën nga Allahu për ta paguar atë.



*“-...S’ka dyshim se te Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që është ruajtur më tepër (nga të këqijat).”*

(Huxhurat, 13)



Tevekkuli: T’i drejtohesh Allahut dhe ta presësh shpresën nga njerëzit.

Abdulkadir Gejlani thotë:

Së pari duhet të sigurosh jetesën dhe të kesh një profesion apo punë që të mos kesh nevojë për asnjë. Ashtu që të të forcohet besimi.

Pasi të punosh dhe të fitosh në profesionin apo në punën tënde, pasi ta sigurosh jetesën dhe të forcohesh, Allahu i cili është i plotfuqishëm dhe i lartë të shpie ty te tevekkuli, kështu

që ta siguron jetesën tënde pa shkaqe.

O ti, që i bën shirk Allahut për shkak të riskut dhe jetesës! Sikur ta kishe shijuar ëmbëlsinë e ushqimit me tevekkul, nuk do t’i bëje shirk Allahut dhe do të qëndroje përpara Tij duke i bërë tevekkul dhe duke iu mbështetur. Unë nuk di gjë tjetër që mund të sigurohet risku përveç këtyre dy gjërave:

1. Krahas mbështetjes shumë të fortë ndaj shariatit, të fitosh duke punuar.



2. Të fitosh me tevekkul, në të dyja puna është themelore. Turp për ty që e lë punën pa u turpëruar nga Allahu dhe u lyp njerëzve. Të fitosh duke punuar, është fillimi i punës. Ndërsa tevekkuli është fundi i saj. Unë te ti nuk po shikoj dot as fillimin dhe as fundin e punës. Domethënë se ti, as nuk punon siç duhet në fillim dhe, as që bën tevekkul në fund.

Vallë a ka ndonjë prej jush që ka ngrënë një kafshatë ushqim duke iu mbështetur vetëm Allahut Teala pa u mbështetur dhe pa i besuar vetes apo njerëzve të tjerë?

Si mund të pohosh se je mysliman, besimtar, njeri që ka besim të patundshëm dhe njeri që i beson teuhidit? Ti vetëm u mbështetesh dhe i beson forcës e fuqisë së vetes dhe shkaqeve. Ndërsa nuk të bie ndër mend

aspak tevekkuli ndaj Allahut dhe besimi ndaj Tij.

## MBËSHTETJA TE ALLAHU

Nga kuvendet shumë të vlefshme të Abdulkadir Gejlanit:

I Dërguari i Allahut (a.s.) thotë:

*-Kush dëshiron të bëhet më i nderuari i njerëzve, le të ketë frikë nga Allahu. Kush dëshiron të bëhet më i forti i njerëzve, le t'i mbështetet Allahut. Kush dëshiron të bëhet më i pasuri i njerëzve, le t'i besojë më shumë asaj që ka Allahu se sa asaj që ka vetë...*

Allahu subhanehu ve teala thotë:

**"-...S'ka dyshim se te Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që është ruajtur më tepër (nga të këqijat)." (Huxhurat, 13)**

Të jesh i devotshëm dhe të kesh frikë nga Allahu, është ndershmëri. Ai që ka frikë nga Allahu dhe është i devotshëm, është njeri i ndershëm. Ndërsa mosbindja ndaj Allahut, është paturpësi dhe poshtërsi.

Kush dëshiron të bëhet i fortë në fenë e Allahut, t'i mbështetet dhe t'i besojë Allahut i cili është i plotfuqishëm dhe i madhëruar, sepse nuk ka dyshim se tevekkuli e rregullon, e forcon, e zbukuron moralisht dhe e tërheq zemrën të e vërteta e i shfaq asaj gjëra të habitshme. Kurrë mos i beso dhe mos u mbështet te para ja dhe pasuria jote, sepse një gjendje e tillë të shpie në dobësi. Mbështetu Allahut teala dhe vetëm Atij besoji, sepse padyshim që Ai të forcon, të ndihmon dhe të jep mirësi.

T'i hap dyert nga disa anë që nuk i ke menduar dhe e forcon zemrën tënde.

Allahu teala nuk dëshiron të shikojë në zemrën tënde diçka tjetër përveç Tij.

Kush e do pasurinë edhe në këtë botë edhe në botën tjetër, le të ketë frikë nga Allahu dhe jo nga të përkohshmit dhe le të turpërohet për të shkuar te dyert e të tjerëve duke e lënë Atë.

## KI FRIKË ALLAHUN ASHTU QË...


Abdullah bin Abbas thotë:

-Një ditë isha pas Pejgamberit të nderuar (s.a.). Ai më tha:

-Biri im! Po të mësoj disa fjalë. Respektoji urdhëresat dhe ndalesat e Allahut që ta kesh pranë Atë. Kur të kërkosh diçka, kërkije nga Allahu. Kur të kërkosh ndihmë, kërkije nga Allahu. Dije mirë se sikur të gjitha krijesat të bashkohen për të të bërë ndonjë mirësi, nuk mund të të bëjnë ndonjë gjë më shumë se sa të ka shkruar Allahu. Po ashtu sikur të gjitha krijesat bashkohen për të të dëmtuar, nuk mund të të dëmtojnë më shumë se sa të ka përcaktuar Allahu. Punët e lapsit kanë mbaruar, edhe shkrimet mbi faqet janë plotësuar dhe janë tharë." (Tirmidhi)

Nga Tirmidhi sipas një transmetimi tjetër thuhet:

-Ki frikë Allahun që ta kesh pranë. Bëje Allahun të të dojë në kohë të mirë, që ai të të ndihmojë në kohë të vështirë. Dije se asnjë gjë nuk të ndodh po nuk qe e shkruar në caktimin hyjnor. Po ashtu askush



nuk mund të të shpëtojë nga ajo gjë që do të të ndodhë.

## TEVEKKULI I TË DËRGUIARIT TË ALLAHUT

Kur lexojmë biografinë e të Dërguarit të Allahut, shikojmë se në jetën e tij nuk ka pasur frikë as sa një grimcë, nuk është shqetësuar dhe nuk e ka prerë shpresën edhe pse i kanë ndodhur tragjedi shumë të këqija dhe fatkeqësi të mëdha. Pejgamberi ynë i dashur ka shfaqur të njëjtën vendosmëri të palëkundshme kur jetoi në Mekë i vetëm dhe pa mbrojtje, kur i ndodhën shumë tragjedi dhe kur u përball me rreziqe të tmerrshme gjatë luftërave në Uhud dhe Hunejn. Kur xhaxhai, Ebu Talibi i tha Pejgamberit (s.a.) që të hiqte dorë nga kjo çështje, iu përgjigj:

-Xhaxha!... Mos mendo se do të ngel vetëm. E vërteta nuk ngel vetëm. Vjen një ditë që arabët dhe joarabët e pranojnë. Një ditë i tha njërit prej sahabëve:



*Ki frikë Allahun që ta kesh pranë. Bëje Allahun të të dojë në kohë të mirë, që ai të të ndihmojë në kohë të vështirë.*

*Dije se asnjë gjë nuk të ndodh po nuk që e shkruar në caktimin hyjnor. Po ashtu askush nuk mund të të shpëtojë nga ajo gjë që do të të ndodhë.*



**-Betohem se dita që do të triumfojë kjo fe është shumë afër. Atëherë nëpër zemra nuk do të ketë frikë tjetër përveç frikës ndaj Allahut.** (Buhari)

Kur i Dërguari i Allahut (s.a.) po kthehej nga lufta e Nexhidit bashkë me sahabët e tij dhe kur po pushonin nën hijen e një peme, të gjithë i kishte zënë gjumi prej lodhjes. Shpata e të Dërguarit të Allahut ishte e varur mbi pemë. Një bedevi që po kalonte aty në ato momente duke përfituar nga gjendja, desh i ta vriste të Dërguarin

e Allahut (s.a.). Kur u zgjua i Dërguari i Allahut, pa se bedeviu po e sulmonte me shpatë.

Bedeviu duke bërëtitur i tha:

-Kush mund të të shpëtojë ty nga dora ime tani?"

Bedeviut i ra në tokë shpata që kishte në dorë kur i Dërguari i Allahut (s.a.) i tha:

-Allahu! Ja, ky ishte tevekkuli dhe mbështetja që kishte Pejgamberi (s.a.) ndaj Allahut. (Buhari, Muslim,)



# Nga dija te tevekkuli

Njeriu e ka shumë të kufizuar dijen në lidhje me të kaluarën e tij. Ai vetë nuk mund t'i kujtojë shumë gjëra të cilat i ka jetuar. Që nga çasti që është krijuar si një gjallesë dhe ka ekzistuar, shumicën e ngjarjeve që patën të bëjnë drejtpërdrejt me të dhe në lidhje me të, i harron. Këtu marrin pjesë edhe ngjarjet që kanë pasur rol shumë të rëndësishëm në jetë. Shumë gjëra që ndikojnë dhe luajnë rol themeltar në ndërtimin e personalitetit të tij, për të nuk mund të jetë gjë tjetër përveç se plan i pasmë i mbuluar i së kaluarës së tij. Edhe pse i ka dhe i mbart ndikimet e tyre, në të vërtetë gjërat që nuk mund t'i kujtojë dhe t'i dijë, janë më

shumë se sa pandehen.

Ndërsa gjërat që mund t'i kujtojë, janë edhe pak, edhe shumë herë nuk mund ta kalojë kufirin e vlerësimit që buron nga metoda psikologjike në të konceptuarit e tyre. Po ashtu nuk mund të thuhet se kujtimet që i janë ngulitur në mendje gjithmonë mund t'i kujtojë plotësisht dhe saktë. Atë që ka ngjarë, edhe nëse e kujton saktë fizikisht, mund t'i japë kuptime të ndryshme sipas konceptit dhe motivacionit të tij dhe mund ta përdorë si material në komentimet personale. Çdo gjëje i jep kuptim sipas psikologjisë, iluzionit dhe animeve personale të tij si dhe ku

ta shikojë kuptimin dhe përfitimtë e tyre. Masat e drejta dhe objektive gjithmonë nuk mund t'i mbrojnë ose nuk mund t'i nxjerrë në plan të parë. Në vrotimet dhe mbresat e tij nuk mban qëndrim të paanshëm dhe nganjëherë e deformon plotësisht të vërtetën.

Veçanërisht në çështjen e punës së tij, për ta bindur veten se është me vend, e saktë dhe e drejtë, mund të gjejë mendime dhe mund të shfaqë justifikime e shfaqësime. Në këtë mënyrë nuk e shikon mangësinë e tij, nuk i vlerëson sjelljet e këqija të tij ose nuk i kupton dhe nuk e pranon fajin e tij. Ndoshta për këtë arsye dhe ngaqë ësh-



të një virtyt i rrallë, kanë thënë se “Nuk ka dituri më të madhe për njeriun sesa të dijë mangësinë e tij”.

Në këtë rrafsh sigurisht që çdo njeri nuk është njëlloj. Besimtarët e të devotshmit dhe veçanërisht atyre që u është dhënë urtësi dhe dijetarët të cilën dalin prej tyre, nuk janë njëlloj si mëkatarët dhe ngatërrestarët të cilët janë të privuar nga besimi. Sigurisht që të mençurit, të ndërgjegjshmit dhe mëkatarët janë në vende të ndryshme. Të gjithë nuk mund të kenë të njëjtin porcion nga dija. Edhe sjelljet dhe ndjeshmëritë ndaj dijes janë shumë të ndryshme.

Natyrë e vërtetë e punës së njeriut dhe se ç’kuptim ka në analizimin e fundit, do të kuptohet vetëm në ahiret. Kuptimi që mbartin veprat dhe sjelljet në një ditë dhe lidhja origjinale e veprës së njeriut me besimin dhe besnikërinë që ka ndaj Zotit, atje do të dalë në pah. Sevapi dhe mëkati atje do të jetë i qartë. Si rezultat i realizimit të takimit me Allahun, çdo gjë që mund ta kujtojmë apo që e kemi harruar do të sqarohet me të gjithë vërtetësinë e saj

dhe në këtë mënyrë të gjithë do ta konceptojnë dijen perfekte që u jep fund plotësisht hezitimeve dhe debateve. Allahu i madhëruar thotë:

**“...Së fundi do të ktheheni te ne. Pastaj edhe ne do t’ju njoftojmë për ato që keni vepruar.”**  
(10/23)

Kujtimi i së kaluarës nga njeriu i cili është pajisur me memorie nga Zoti i madhëruar dhe përfitimi nga kjo si përvojë dhe akumulim, përfitimi i tij si një themel që ia ndriçon rrugën e jetesës, ndërgjegjen dhe gjykimin, është një mirësi dhe nder që i përket njeriut.

Ndërsa shkencat që përfaqësojnë shkallën e mbartjes së natyrës dhe cilësisë së lartë të dijes së njeriut e cila është një produkt i aftësisë së vrojtimit, mendjes dhe memories, këto përgjatë kohës vazhdimisht janë të lidhura pas një procesi akumulimi dhe ndryshimi.

*Kanë thënë se:*

*“Nuk ka dituri më të madhe për njeriun sesa të dijë mangësinë e tij”*

Disiplinat e ndryshme shkencore në fushat e tyre gjatë kohës zhvillohen dhe duke ndryshuar themelet teorike të tyre, tjetërsohen teorikisht. Kjo gjë reale mund të shikohet me rezultatat teknologjike dhe ndikimet në kuptim civil. Kështu, ndryshimi që shikohet në kuptim epistemologjik i degëve të dijes, nxjerr në pah se edhe dija e njeriut në shkallë shkencore mbart vetëm një vlerë relative. Së fundi jemi të detyruar të pranojmë këtë: dija e njeriut e cila në të vërtetë është e kufizuar, nisur nga çdo nivel shkencor dhe joshkencor, ngel



në një fushë shumë të ngushtë dhe mbart vetëm një vlerë relative ndaj dijes së vërtetë të Allahut.

Në anën tjetër njeriu mund të ketë hamendje në lidhje me të ardhmen, kështu që në këtë çështje mund të flitet për shpresat dhe intuitat e tij. Ai mund të ketë plane dhe parashikime në lidhje me të ardhmen, po ashtu mund të ketë edhe punime dhe masa sipas tij në lidhje me këtë. Por këto nuk tregojnë se ai ka mundësi ta dijë të ardhmen dhe ta përcaktojë atë. E ardhmja është e paditur për njeriun. Kjo është e qartë se e ardhmja e njeriut nuk mund të dihet dhe për këtë arsye nuk mund të bëhet fjalë që të jemi të sigurt për fundin e askujt. Edhe i Dërguari i Allahut Muhamed Mustafai (s.a.v.) i cili ishte robi i zgjedhur i Allahut, nuk e dinte gajbin (përveç asaj që i shpallte Allahu).

**“Thuaj: “Unë nuk u them juve se kam thesaret e Allahut, as nuk pretendoj se e di të fshehtë, as nuk u them se unë jam engjëll. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet mua. Thuaj: “A janë njëlloj i verbëri dhe ai që sheh?” A nuk me-**



**ndonj?” (6/50)**

**“Thuaj: “Unë nuk kam në dorë për veten time as ndonjë dobi, as ndonjë dëm, përveç çfarë do Allahu. Sikur ta dija të fshehtë, do t’i shtoja të mirat për vete dhe nuk do të më ndodhte ndonjë gjë e keqe. Unë nuk jam tjetër vetëm se qortues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë.” (7/188)**

Siguria dhe posedimi i saj janë nga nevojat më themelore për njeriun. Duke e lënë dijen në një anë, çdo njeri u beson dhe mbështetet te disa gjëra me qëllim që të sigurojë të paktën të ardhurat e tij me kohë të

caktuar dhe planet që ka parashikuar për të ardhmen e afërt. Të gjithë njerëzit në këtë mënyrë u besojnë dhe mbështeten të disa gjëra ose gjithmonë e kërkojnë diçka të tillë.

Në këtë kontekst e gjithë siguria dhe besimi nuk ka zgjidhje tjetër përveçse të lidhet me Allahun. Asnjë njeri që i beson Zotit, që e njeh konceptin e hyjnësië dhe që ka respekt për këtë, nuk i beson dhe nuk i mbështetet asnjë gjëje në një kohë që Ai ekziston. Që njeriu t’i kthehet vetëm Zotit në konceptin e besimit dhe të mbështetjes domethënë të tevekkulit, është një nevojë e pa-



shmangshme e teuhidit ose me një shprehje tjetër, e përsosjes në zemër (e të kuptuarit duke e ndjerë me të gjithë madhësitinë e tij) të konceptit dhe të besimit në Zot.

**“... dhe vetëm Atij le t’i mbështeten ata që besojnë.”**  
(12/67)

Çfarë gjëje tjetër mund t’i besojë njeriu përveçse mëshirës së Allahut ndërmjet së kaluarës që nuk mund ta dijë plotësisht, për të cilën nuk është i sigurt për drejtimin e vlerën përfundimtare dhe të ardhmes që pothuajse nuk mund ta dijë aspak? Çfarë mund të pohojë dhe të marrë në emër të tij? Në një udhëtim ku e kaluara është e dyshuar ose të paktën e paqartë dhe e ardhmja është e paditur, çfarë mund të bëjë tjetër përveçse t’i dorëzohet Atij dhe t’i mbështet Atij ndërkohë që planifikon rrugën duke i rezistuar mjedisit të mbushur me shumë faktorë që nuk mund të dihen dhe kontrollohen?

Në fakt ekzistenca individuale dhe identiteti personal i njeriut që nga ekzistenca e deri në fundin e tij, vetëm me lejen e Atij bëhet një tërësi komplet

tjetër. Është Zoti Ai që i lidh të gjitha momentet e jetës së njeriut me njëra-tjetrën dhe që krijon ura ndërmjet së kaluarës dhe së ardhmes. Është sundimi i Tij mbi robin, është përcaktimi dhe vullneti i Tij që ia jep personalitetin robit të vet. Vazhdimësinë e personalitetit ose më saktë bërja e tij posedues të një personaliteti, që prej krijimit e deri në takimin me Zotin, ia ka borxh krijimit të njëjtë dhe të vetëm të Zotit. Zoti është poseduesi i së kaluarës dhe i së ardhmes së tij. Në të kaluarën dhe në të ardhmen Ai është sundimtari absolut, vëzhguesi dhe dëshmitari i adhurimit të tij.

Në këtë rrugë dija e njeriut mund t’i cilësojë gjërat dhe mund të formojë lidhjen që kanë ndërmjet tyre. Me këtë aftësi ndahet nga krijesat e tjera. Por porcioni i vërtetë në aspektin e dijes me këtë pajisje

**“... dhe vetëm Atij  
le t’i mbështeten ata që  
besojnë.”**

(12/67)

padyshim është që ai ta njohë Zotin e tij dhe t’i kuptojë emrat e bukur të Tij. Kështu ky është besimi, udhëzimi dhe në të njëjtën kohë konceptimi i pozitës së adhurimit të tij. Ai duhet t’i kuptojë argumentet që gjenden në veten e tij dhe në botën e jashtme duke i parë dhe të arrijë besimin e saktë dhe të vërtetë duke u mbështetur në themelin e tevhidit (njësimi të Zotit) dhe tenzihit (besimi se Zoti është i pastër nga të gjitha mangësitë). Ky është porcioni më fisnik për njeriun i cili e bashkon atë me urtësinë e krijimit të tij.





## *Tevekkuli në Allahun xh. sh.*

**F**alënderimi absolut i qoftë Allahut xh.sh., paqja dhe shpëtimi qofshin mbi kryetarin e tevekkulit, mbi sahabët madhështorë e të famshëm, mbi ne dhe mbi të gjithë adhuruesit vepërmirë.

Përhapja e injorancës në forma të ndryshme në mesin e ymetit është dukuri e pakuptimtë në fe, çështje e cila nuk është e padukshme për çdo njeri i cili ka shikim të shëndoshë.

Andaj, nga kjo nuk mund të

shpëtohet edhe nëse zotërohen diploma akademike dhe pozicione të hierarkisë më të lartë shtetërore. Injoranca për të cilën e kemi fjalën ka të bëjë me bazat e Fesë dhe të besimit, e mos të flasim për çështje tjera të legjislativit dhe të dispozitave islame. Rezultat i kësaj injorance është besimi i gabuar në Njëshmërinë e Allahut xh.sh., përkundër qartësisë së kësaj çështjeje.

Andaj, po të parashtrahet çështja e tevekkulit në Allahun xh.sh., ose çështja e frikës dhe shpresës në Të, ose çështje tjera që i takojnë fushës së

ibadetit (adhurimit) me

të cilin assesi nuk guxohet t'i drejtohem dikujt tjetër pos Allahut xh.sh., do të shi-

het se shumë njerëz kanë kuptim të gabuar në këto çështje. E, të kuptuarit e këtyre çështjeve në mënyrë të shtrembëruar e të gabuar jep shtytje për në besëtytni dhe në mëkat të pafajshëm.

Prandaj, këto çështje duhen seleksionuar, pastruar e sqaruar për të qenë këshillë për myslimanin, e kjo më esencialisht do të realizohej duke marrë mësim nga jeta e Pejgamberëve të Allahut xh.sh.

Ndaj, çështja më kundërthënëse, e paqartë dhe problematike është ajo e tevekkulit në Allahun xh.sh.

Pra nuk është numër i vogël i të tillëve të cilët tevekkulin e kanë te kryetarët, mbretërit, personalitetet e ministrat për kryerjen e nevojave dhe kërkesave të tyre. Parashtrahet pyetja, ç' është e vërteta e tevekkulit, si duhet kuptuar ai dhe cila është vlera dhe pesha e tij?

E vërteta për tevekkulin është: Mbështetja absolute në Allahun

xh.sh. për të gjitha çështjet, qofshin ato për të arritur një dobi të caktuar ose për të penguar një dëm të caktuar.

Tevekkuli është ibadet madhështor, ai nuk bëhet duke iu drejtuar dikujt tjetër pos Allahut xh.sh.. Besimtari i sinqertë i mbështetet vetëm në Allahun, për çdo çështje, siç janë: kërkimi i furnizimit e i ndihmës, për shërim e shëndet, për pengimin e së keqes e dëmit, dhe beson bindshëm se nuk ka furnizues përpos Allahut xh.sh., se nuk mund të ofrojë ose të pengojë dikush diç pos Allahut xh.sh., se Ai është i Lartëmadhëruar, Krijues, Mbikëqyrës dhe Zot i të gjitha botëve. Ai në Librin Fisnik ka urdhëruar për mbështetje të sinqertë dhe mes të tjerash thotë: "... e mbështetu Allahut se Ai është mbrojtje e mjaftueshme." (El-Ahzab,48)

Në suren En-Neml,ajeti 79, thotë:" E ti pra,mbështetu në Allahun se me të vërtetë ti je në të drejtën e sigurt."

Allahu e ka bërë mbështetjen kusht për të qenë besimi i shëndoshë, ja se ç' thotë:" Dhe vetëm Allahut mbështetuni, nëse jeni besimtarë të sinqertë." (El-Hadidë,23)

Gjithashtu në Kur'an thuhet:" ... vetëm Atij mbështetuni, nëse jeni të dorëzuar (vendimit

të Tij)." (Junus,84)

Shembuj nga mbështetja i peygamberëve

Kur'ani paraqet shembuj të mrekullueshëm për tevekkulin e peygamberëve të cilët i drejtuan popujt e tyre në vepra të mira e i larguan nga të këqijat. E, njëri prej tyre është Hudi a.s. i cili qenien e tij ja përkushtoi porosisë me të cilën ishte ngarkuar. E këshilloi dhe ja tërhoqi vërejtjen popullit të tij, por nuk hasi në mirëkuptim dhe dëgjueshmëri, përkundrazi, hasi në mosbesim, në mëkate dhe fyerje të rënda. Ja se ç' thotë Kur'ani:" Ata thanë: O Hud, ti nuk na solle ndonjë argument, e ne nuk i braktisim zotat tanë për fjalën tënde dhe nuk të besojmë ty. Ne nuk themi tjetër vetëm se dikush prej zotave tanë të ka goditur e ti je çmendur!..." (Hudë,53-54) Megjithatë, Hudi a.s. thirrjen e tij e bëri me ngulm e largpamësi ashtu siç bën besimtari i konsoliduar me Zotin e tij dhe që ka mbështetje absolute në Të, nga njëra

anë, e nga ana tjetër, i ironizuar me pakujdesinë e mendjetarshësinë e tyre, u kundërvihet në mënyrë të prerë:" ... Ai tha: Unë i jam mbështetur Allahut, Zotit tim dhe Zotit tuaj, pse nuk ka asnjë nga gjallesat, e që Ai të mos e ketë nën sundim,vërtet, Zoti im është i drejtë." (Hudë,54-56).

Edhe Ibrahim a.s. qëndroi i paluhatshëm kundër kokëfortësisë së t' et dhe popullit të tij, mu ashtu siç i ka hije besimtarit të cilit i flenë besimi në zemër. Ai popullin e vet e thirri me urtësi, butësi dhe dëshmi, megjithatë hasi në kokëfortësi dhe zemra në të cilat besëytënia kishte bërë vend. Kështu që, populli i tij i bënte kurthe, e më në fund një muaj tuboi dru dhe e ndezi zjarrin për të djegur Ibrahim a.s. Njerëzit u tubuan



për të parë se ç'po ndodhte, e njëherit e fyenin Pejgamberin e Allahut, mirëpo, kur vjen momenti që atë ta hedhin në zjarr, atë as që e kaploi paniku e as frika, por e tha fjalën madhështore: "Mua më mjafton Allahu, e sa mbështetje e mire është Ai."

Fjalë të cilën nuk e thotë kush pos muminit, me të cilën nuk shprehet vetëm mbështetje i sinqertë. Prandaj, kur u mbështet në Allahun, Ai i mjaftoi, e meqë ishte i sinqertë ndaj Tij, u lirua dhe shpëtoi, shih për këtë fjalët e të Madhit Allah: "Po Ne i thamë: O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!

Ata deshën t'i bëjnë atij (Ibrahimit) kurth, po ne ata i bëmë më të dështuarit. (Enbija,69-70).

Tani është

fjala për kryeparin e tevekkulit Muhamedin a.s., jetëshkrimi i të cilit është përplot me mbështetje të pashoqe dhe bindje madhështore në Allahun xh.sh. Ai migroi me Ebu Bekrin r.a. të cilët hynë në shpellë ku u strehuan dhe u fshehën. Ndërkaq, mushrikët (idhujtarët) iu vunë në shpinë për t'i ndjekur e për t'u ranë gjurmë, edhe u ndalën te shpella, pikërisht pranë hyrjes së saj. Me atë rast sahabiu Ebu Bekri u frikësua se mos vallë po i ndodhë ndonjë e keqe pejgamberit të Allahut, prandaj iu drejtua me fjalët: "O pejgamber i Allahut, po ta ulë ndonjëri kokën e të shikojë do të na shoh, përgjigja e pejgamberit, me plotë bindje, siguri e mbështetje në Allahun, ishte: "Mos u dëshpëro se Allahu është me ne". Në vendin e quajtur "Hamraul-essed" idhujtarët u tubuan për ta luftuar Muhamedin a.s.

dhe shokët e tij. Për këtë, Pejgamberi me shokët do lën me një guxim dhe trimëri të paparë, me

*Kur'ani paraqet shembuj të mrekullueshëm për tevekkulin e pejgamberëve të cilët i drejtuan popujt e tyre në vepra të mira e i larguan nga të këqijat.*

vendosmëri e zemërgjerësi për t'u përballur e ndeshur me turmën e cila ishte në pritë. Mirë po, kjo ushtri ishte kompakte dhe e mbështetur absolutisht në Allahun Një duke kërkuar suksesin nga Lartmadhëria e Tij. Shih për këtë fjalën e Allahut xh.sh.: "E atyre (shokëve të pejgamberit) që dikush u tha: Populli (idhujtarët) është tubuar t'ju sulmojnë, pra kini frikë! Ajo, vetëm ua shtoi edhe më shumë besimin e thanë: Neve na mjafton që kemi Allahun, Ai është mbrojtësi më i mirë! E ty të mos brengosin ata që përpiqen për mosbesim, ata kurrsesi nuk mund të dëmtojnë aspak Allahun. Allahu

me urtësinë e vet dëshiron që atyre të mos u takojë kurrfarë e mire në botën tjetër dhe ata kanë një dënim të madh.”(Ali Imran,173-174).

Ibn Abbasi r.a. thotë: Ibrahimi a.s. e tha fjalën:

“Më mjafton Allahu dhe sa mbështetës i mirë është Ai”, kur u hodh në zjarr, e Muhamedi a.s. e shprehu kur dikush tha:”...populli (idhujtarët) është tubuar t’ ju sulmojë, pra kini frikë!”

### RELACIONI MES MBËSHTETJES DHE SHKAKUT

Tevekkuli në Allahun xh.sh. nuk refuzon marrjen në konsideratë të shkakut, përkundrazi, marrja në konsideratë e shkakut është fryt i mbështetjes së sinqertë, i Fesë së shëndosh, i besimit të fortë dhe bindjes së fuqishme. Por, e keqja e së keqes qëndron në atë që mbështetja të qëndron kryekëput në shkakun, ndërkaq të harrohet shkaktari e Ai është Allahu xh.sh. Po sjellim dy shembuj konkretë. Për të pritur pasardhës, duhet bërë martesë. Për të pritur të ardhura mujore, duhet me u marrë me ndonjë veprimtari, e kështu me radhë. Prandaj, njeriu duhet të bëjë atë që është në kompetencat e tij, pastaj vjen tevekkuli. Mirë po, pa marte-

së lindi Mejremja r.a., por kjo është mrekulli, sofrë e Isait a.s. zbriti nga qielli, por edhe kjo është mrekulli.

### LLOJET E MBËSHTETJES

Ka katër lloje të mbështetjes.

**Lloji i parë.** Ai është mbështetje në Allahun xh.sh. për të gjitha çështjet, qoftë për të arritura një të mirë, qoftë për të penguar një të keqe, dhe ky lloj i mbështetjes është kusht për besim të shëndosh.

**Lloji i dytë.** Ajo është mbështetje në krijesën në të cilën nuk mund të ketë gisht askush pos Allahut të Lartëmadhëruar, siç janë: të rënit e shi, shërimi i të sëmurit, realizimi i ndihmës, etj. çështje të cilat janë specifika Hyjnore. Ndaj, nëse mbështetja absolute bëhet në fenomenet natyrore të lartshënuara, kjo pa diskutim është besëtytni e cila shkakton hyrjen në xhehenem për jetë e mot.

**Lloji i tretë.** Kjo është mbështetje në krijesat, siç janë: kryetarë,

mbretër, personalitete e përgjegjës të cilëve Allahu ju ka mundësuar për të evituar një të keqe të caktuar, ose për të ofruar një të mirë të caktuar, edhe kjo është besëtytni meqë mbështetja absolute duhet të jetë në Allahun xh.sh.


**Lloji i katërt.** Kjo është mbështetje në njëri-tjetrin në veprimtarit e përditshme, por përsëri mbështetja absolute i takon Allahut xh.sh.

Kush i përmbahet mbështetjes absolute në Allahun xh.sh.?

Mbështetjes absolute në Allahun e Lartëmadhëruar i përmbahet ai i cili është i kënaqur me Allahun për Zot të tij, me Islamit për fe të tij dhe me Muhamedin a.s. për pejgamber të tij.



## Mbështetja në Allahun xh.sh.



*Allahu i Lartësuar kur përmend cilësitë e besimtarëve thotë: "Besimtarë të vërtetë janë ata, të cilët kur përmendet Allahu u rrënoqethen zemrat (nga frika), e kur u lexohen ajetet e tij (Kur'ani) u shtohet besimi dhe tek Zoti i tyre janë të mbështetur."*

(Enfalë, 2)



Njerëzit nuk humbin përveç se duke u mbështetur në gjërat materiale, duke u lodhur në realizimin e tyre, kurse harrojnë se nuk kanë për të arritur përveç asaj që ua ka caktuar Allahu xh.sh.

**"Tevekkuli"** nënkupton mbështetjen në Zotin xh.sh. dhe të besuarit e të gjitha çështjeve Atij. Myslimani i vërtetë është ai që ia nënshtron veten Allahut të Lartësuar me përkushtim e devotshmëri dhe të gjitha çështjet ia dorëzon Vullnetit të Tij, duke besuar se Allahu xh.sh në Kur'an urdhëron e thotë: Thuaj: "Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve!" (En'amë, 162).

Çdo njeri ka nevojë për ndihmëtar, ka nevojë për dikë që të mbështetet tek ai, t'i mbështetet atij me gjithë zemër. Për këtë

arsye mbështetja tek Allahu xh.sh. është prej gjërave më të rëndësishme dhe prej obligimeve më të domosdoshme, është cilësi e besimtarëve dhe kusht i besimit. Ajetet kurane që tregojnë mbështetjen në Allahun xh.sh. janë të shumta, Allahu xh.sh. në Kur'an urdhëron e thotë: "Mbështetuni Allahut nëse jeni besimtarë!" (Maide, 23), Allahu i Lartësuar kur përmend cilësitë e besimtarëve thotë: "Besimtarë të vërtetë janë ata, të cilët kur përmendet Allahu u rrënoqethen zemrat (nga frika), e kur u lexohen ajetet e tij (Kur'ani) u shtohet besimi dhe tek Zoti i tyre janë të mbështetur." (Enfalë, 2)

Prej gjërave të cilat e sqarojnë tevekkulin është edhe rasti i Pejgamberit a.s. dhe Ebu Bekrit r.a. në shpellë. Ebu Bekri r.a. thotë: "pashë këmbët e mushrikëve duke qenë



në shpellë dhe thashë: O i dërguar i Allahut, nëse ndokush prej tyre e ul shikimin do të na shohë. Pejgamberi a.s. tha: "O Ebu Bekr, ç'të merr mendja për dy njerëz, ku i treti me ta është All-llahu xh.sh". **(Buhariu dhe Muslimi)**. Këtë e vërteton edhe ajeti kuranor ku Allahu xh.sh. urdhëron e thotë: "...Kur që të dy ishin në shpellë, kur po i thoshte shokut të vet: "Mos u pikëllo (friko), All-llahu është me ne!". **(Tevbe: 40)**.

Pejgamberi a.s. ka thënë: "Fjala e fundit që ka thënë Ibrahim a.s. kur e kanë hedhur në zjarr ka qenë: **"Hasbijallah ve nimel-vekil"**- Më mjafton All-llahu, Ai është më i miri mbrojtës" **..(Buhariu)**.

Të mbështeturit në Zot xh.sh. nuk do të thotë se njeriu nuk duhet të ndërmarrë asnjë veprim, se nuk duhet të bëjë asnjë

punë dhe se duhet të qëndrojë kot duke ia dorëzuar të gjitha punët Zotit xh.sh, duke besuar dhe qëndruar pas tezës se Ai do të sigurojë gjithçka pa dhënë asnjë fije mund nga ana e këtij.

Besimi në Zot xh.sh. nënkupton që njeriu e jep mundin e vet maksimalisht dhe vazhdimisht për ta arritur qëllimin dhe më pas ia lë rezultatet Allahut të Lartësuar me besim se Ai do t'ia pranojë këto përpjekje dhe se do ta bekojë me sukses. Në Kur'anin Famëlartë Allahu xh.sh. urdhëron e thotë: " Njeriut nuk i takon tjetër vetëm ajo që ka punuar!" **(Nexhm, 39)**.

Prandaj, nga myslimani pritet që në mënyrë të përzemërt ta fusë veten në veprim dhe pastaj të mbështetet tek Zoti xh.sh. për rezultate të mira.

Transmeton Imam Tirmidhiu nga Enesi r.a, i cili thotë: Erdhi një njeri te Pejgamberi.a.s. dhe i tha: o i Dërguar i Allahut, a ta lidhi devenë dhe të mbështetem në Allahun, ose mos ta lidhi dhe të mbështetem në Allahun? Pejgamberi a.s: Iu përgjigj: "Lidhe dhe mbështetu në Allahun xh.sh". **(Hadith sahih)**.

Në një hadith që transmetohet nga Omer bin Hattab r.a. i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: "Nëse i mbështeteni Allahut të Madhëruar me mbështetje të plotë, do t'ju japë rriskun (do t'ju furnizojë juve) ashtu sikur se ia jep rriskun zogjve, të cilët dalin të uritur dhe kthehen të ngopur." **(Ahmedi dhe Tirmidhiu)**

# Disa çështje të rëndësishme mbi Tevekkulin



*Natyrshëm lind pyetja nëse ka një mbështetje më të madhe absolute ku njeriu të gjejë forcë dhe kurajë? Dhe padyshim që e vetmja mbështetje mbetet ajo e Allahut fuqiptotë.*



**K**ur flasim rreth një çështjeje të tillë padyshim që mendojmë për mbështetjen që kemi dhe duhet të kemi tek Allahu fuqiptotë, tek Krijuesi i Gjithësisë. Njeriu, si qenie e kësaj bote, si për nga natyra ashtu edhe për kushtet që e rrethojnë, e ka të domosdoshme të kërkojë mbështetje e cila i jep siguri në vetvete për të shkuar më tej, në realizimin e aspiratave të tij. Por nuk është e nevojshme ndoshta të ecet kaq gjatë, pasi në çdo moment të ditës ne lutemi të kemi shë-

ndet të plotë pa të cilin nuk mund të bëjmë qoftë edhe një hap, dhe vetëm kjo na mjafton të kuptojmë se nuk bëjmë gjë tjetër por vetëm se kërkojmë mbështetje dhe siguri për jetën tonë.

Në një këndvështrim tjetër, në çdo fazë të jetës njeriu kërkon mbështetje. Fëmija kërkon mbështetje tek prindi i vet, nëna dhe babai, i rrituri kërkon mbështetje jo vetëm në familje por edhe në shoqëri, dhe kjo kërkesë sa vjen e rritet dhe bëhet mjaft e dukshme.

Natyrshëm lind pyetja nëse ka një mbështetje më të madhe absolute ku njeriu të gjejë forcë dhe kurajë? Dhe padyshim që e vetmja mbështetje mbetet ajo e Allahut fuqiptotë.

Në një ajet Kuranor thuhet:

**“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej teje ndihmë dhe udhëzim kërkojmë”**

Është pikërisht sureja “El-Fatiha”, baza e Kur’anit Famëlartë, që përmban një ajet të tillë kaq domethënës dhe që

ne e themi në çdo namaz dhe në çdo moment të ditës, pasi kështu ne arrijmë të shprehim pafuqishmërinë tonë ndaj situatave të ndryshme të jetës.

Një pikë mjaft e rëndësishme që e mbron njeriun nga devijimi i kësaj rruge, është edhe shmangia nga dembelizmi. A keni menduar ndonjëherë se ç'është dembelizmi dhe ç'pasoja u sjell njerëzve? Mos vallë ju duket pak sa fëminore një pyetje e tillë? Pothuajse çdokush e di se dembelizmi është diçka negative dhe askush nuk e pranon një fenomen të tillë, por vallë sa vetë janë përpjekur për të kuptuar nëse janë apo jo dembelë? Dembelizmi jetohet ose mendërisht ose fizikisht ose që të dyja së bashku. Një pjesë e njerëzve nuk e vënë në punë mendjen, një pjesë tjetër nuk vënë në

punë fizikun ndërsa pjesa më e madhe as mendjen dhe as fizikun e tyre. Tek njerëzit e tillë vihen re shenja të tilla si: dëshira për të pushuar i bën ata që të ulen dhe të rrinë gjatë, të shohin televizor, të dëgjojnë muzikë, të merren me thashetheme dhe të bëjnë një jetë të pakontrollueshme.

Njerëzit aktiv fluturojnë mes suksesesh të admirueshme. Pse ka disa njerëz që e përballojnë vështirësinë fizike dhe mendore edhe në kushte të vështira dhe disa të tjetër menjëherë e braktisin? Njerëzit anashkalojnë çdo lloj aktiviteti që shohin se ka një rritje volumni. Padyshim që edhe trupi ka një kapacitet të tij dhe njeriu që punon e tejkalon shumë shpejt këtë kufi. Por kur bëhet fjalë për kapacitetin e trurit, puna ndryshon pasi fuqia e tij është aq e gjerë sa nuk mund të kapërcehet lehtë.

Kur i hedhim një sy mirësive të Allahut vëmë re se Ai e ka krijuar njeriun në mënyrë të përkryer dhe këtë mund ta vëmë re që tek muskujt të cilët kanë një qëndrueshmëri kaq të fortë, pavarësisht nga lodhja që pëson njeriu. Një tjetër organ i palodhur i njeriut është edhe truri i cili punon në mënyrë të pareshtur për sa kohë të jetë i ushqyer mirë me oksigjen dhe proteina. Ka njerëz që preferojnë

*Dembelizmi jetohet ose mendërisht ose fizikisht ose që të dyja së bashku. Një pjesë e njerëzve nuk e vënë në punë mendjen, një pjesë tjetër nuk vënë në punë fizikun ndërsa pjesa më e madhe as mendjen dhe as fizikun e tyre.*

dembelizmin me qëllim që edhe truri të pushojë. Përkundrazi një gjë e tillë vetëm e dembelos trurin dhe nuk e vë në funksion. Ajo që ne e quajmë "lodhje mendore" nuk është gjë tjetër vetëm një situatë që krijohet nga lënia mënjanë e kushteve fizike gjatë punës dhe ndikimet fiziologjike dhe psikologjike. Ne mendojmë se truri ynë pushon në kohën kur flemë, por nuk e kuptojmë se truri është përherë në punë në çdo moment të ditë e të natës.

Nuk mund të mendohet se ka diçka në këtë jetë që është krijuar pa ndonjë shkak apo arsye dhe njeriu duhet të vërë në funksionim trurin e tij për të kuptuar se ku qëndron e fshehta e një situatë të tillë. Njeriu është i detyruar të kuptojë çdo rrethanë që krijohet dhe që padyshim ka lidhje me të, që të dije dhe të kuptojë pse ka ardhur në këtë jetë. Me të vërtetë, kur Allahu dëshiron, shkaqet lehtësohen por që përsëri mendja njerëzore është shumë e kufizuar për të kuptuar të gjitha arsyet e të





gjitha gjërave. Nuk duhet të harrojmë se mirësitë e Allahut janë të fshehura në bashkimin e shkaqeve shpirtërore me ato materiale. Prandaj njeriu asnjëherë nuk duhet të futet në pesimizëm për mundësitë që i humbasin, por asnjëherë nuk duhet t'i lërë mënjane rastet dhe shkaqet që i dalin përpara. Për këtë, ai vazhdimisht duhet t'i bëjë dua Allahut të lartë, krijuesit të Tij për mundësitë e dhëna në këtë botë. *Gazaliu thotë: "Ka shkaqe me influencë të madhe dhe të sigurte që e mbrojnë dhe e ruajnë njeriun nga dëmet e ndryshme dhe pikërisht nuk është kusht i tevekkulit t'i lësh mënjane këto shkaqe. Të mbyllësh derën e shtëpisë se mos hyjnë hajdutët, të mbash armë në vende të rrezikshme, të kesh kujdes prej armiqve, nuk është pengesë për tevekkulin"* Mosvënia re e shkaqeve, moskryerja e detyrës që të takon, shkurt dembelizmi, pra të

bësh sikur nuk i sheh mirësitë e Allahut, pra të mos kuptosh injorancën që të ka kapluar, varfërinë, sëmundjet etj., të gjitha këto janë të pafalshme dhe haram sipas fesë.

Një tjetër pikë e rëndësishme është edhe të dish vlerën e vërtetë të shkaqeve që do të thotë se kemi të bëjmë me një rrugë që të çon drejt Zotit për të kërkuar edhe mbështetjen e Tij. Të gjitha gjërat që ndodhin në këtë jetë dhe arsyet e tyre janë vetëm për të kuptuar ndikimin hyjnor. Por qëllimin nuk duhet ta presim nga askush tjetër, përveç Allahut, pasi vetëm Ai është që na ka dhënë jetë neve dhe të gjitha gjallesave në këtë botë. Disa dijetarë thonë: "Mos thoni që punuam për një punë, u përpoqëm dhe tashmë nuk mund të bëhet asgjë, por thoni, ne u përpoqëm, kërkuam prej Tij,

tashmë, nëse Ai dëshiron dhe lejon, puna kryhet".

Elmalli Hamdi Yazar thotë: "Allahu e zbaton urdhrin e Tij në çdo kohë. Dëshirën e Tij e bën realitet dhe nuk përvojohet nga asgjë. Ai i vendos rregullat sipas dëshirës së Tij. Edhe kur njerëzia i mbështet edhe kur nuk i mbështet, përsëri Ai i vendos ligjet. Të gjitha gjërat e kësaj bote janë kalimtare: dhembja, gëzimi, vështirësitë lumturia, qetësia. Kur vjen meleku i vdekjes, vdekja është e padiskutueshme. Të mirat mbesin me të mirat, të këqijat me të këqijat. Të gjithë mblidhen me veprat e tyre. Por edhe mbështetja tek Allahu është një urdhër i Tij. Nëse dëshira e atij që kërkon mbështetje tek Allahu, është dorëzim në vullnetin dhe pëlqimin e Allahut, edhe Allahu shton shpërblimin ndaj tij. E



vërteta është që Allahu ka përcaktuar një masë dhe një kufi për çdo gjë dhe çdo gjë e vë në lëvizje sipas këtij kufiri të përcaktuar. Ai nuk i tejkalon këto kufij. Ky është një parim ligjor i padiskutueshëm. Çdo gjë kalon, çdo shkak pozitiv apo negativ konsumohet, kaderi i përcaktuar përfundon, Ai që mbetet është vetëm Allahu me plotfuqishmërinë e Tij. Nëse Allahu nuk urdhëron për diçka, ajo nuk bëhet e, nëse Allahu urdhëron, ajo pasqyrohet tek të tjerët. Zjarri flakëron aq sa i është urdhëruar. Edhe dhuntia jepet aq sa kërkohet nga ana e Allahut. Pra, besimi tek shkaqet është i fundmë ndërsa tek Allahu është i pafundmë. Prandaj dija e sigurte dhe fuqia është në mbështetjen tek Allahu dhe jo në besimin tek shkaqet. Edhe tevekkuli është një devotshmëri, të pranosh fajin, të besosh në fuqinë

e Allahut dhe të dorëzohesh në vullnetin e tij.”

Një pikë tjetër e rëndësishme është të mos i besosh askujt tjetër përveç Allahut. Ka sa e sa njerëz që u besojnë pasurisë që kanë, postit në të cilin ndodhen, lidhjes që kanë me njerëzit e mëdhenj, fëmijëve të tyre me arsim të lartë etj. Qenia pranë tyre ka bërë që ata të krijojnë një lloj sigurie dhe mbështetje për të ardhmen. Por nuk e kuptojnë se kanë mbetur larg Allahut. Ata kanë krijuar besimin se janë këto elemente që u dhurojnë atyre qoftë edhe një buzëqeshje. Por që të gjitha këto për një

*Disa dijetarë thonë: “Mos thoni që punuam për një punë, u përpoqëm dhe tashmë nuk mund të bëhet asgjë, por thoni, ne u përpoqëm, kërkuaam prej Tij, tashmë, nëse Ai dëshiron dhe lejon, puna kryhet”.*

moment mund të zhduken. Atëherë ku do ta gjejë njeriu mbështetjen dhe lumturinë e tij? Padyshim vetëm tek Allahu, Krijuesi i tij. Pasi vetëm Ai mund ta mundësojë një gjë të tillë dhe një besimtar i vërtetë është plotësisht i vetëdijshëm për një hap të tillë.



# Jam mbështetur te Allahu



*Për njeriun që i mbështetet Allahut, ndodhin edhe gjëra të cilat dalin jashtë natyrës së shkaqeve për të cilat ne jemi mësuar t'i shikojmë.*



Mbështetja te Allahu (xh.sh) dhe lidhja e fortë e zemrës me Madhërinë e Tij konsiderohet një prej shkaqeve kryesore që bëjnë të mundur realizimin e dëshirave tona, largimin e gjërave të padëshiruara dhe plotësimin e nevojave. Sa më fort që zemra të lidhet me mbështetjen në Zotin (tevekkulin), aq më mirë dhe në mënyrë të plotë do të realizohen punët. Kjo ka qenë gjendja e të gjithë të dërguarve të Zotit (xh.sh). Në historinë e Ibrahimit (a.s) vëmë re se kur atë e vendosën në zjarr për ta djegur, transmetohet se i erdhi Xhebraili. (a.s) dhe i tha: “A ke

gjë nevojë?”. Ibrahimit (a.s) ia ktheu: “Për ty nuk kam nevojë, ndërsa për Allahun (xh.sh), Ai më mjafton dhe është Mbështetësi më i mirë”, e zjarri u bë i ftohtë dhe i padjegshëm”. Duke ditur se Xhebraili (a.s) kishte fuqi ta shuajë zjarrin me një cep krahu, zemra e Ibrahimit (a.s) nuk u lidh për krijesa që të përfitojë prej tyre dhe të largojë rreziqet.

Të njëjtat fjalë tha edhe sahabiu i nderuar Hamra Esed mëngjesin e ditës së Uhudit. Për këtë Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: “E atyre (shokëve të Pejgamberit) që dikush u tha: “Njerëzit janë tubuar t’ju


sulmojnë, pra kini frikë!” Ajo, vetëm ua shtoi edhe më shumë besimin e thanë: “Neve na mjafton që kemi Allahun, Ai është mbrojtësi më i mirë! Dhe ata pa i gjetur asnjë e keqe fituan begati e mirësi të mëdha nga Allahu dhe e arritën kënaqësinë e Tij, Allahu është dhurues i madh”. (Ali Imran: 173-174).

Kur Musai (a.s) u nis drejt Medjenit, tha: “E kur arriti ujin e Medjenit, aty gjeti një grumbull njerëzish që po i jepnin bagëtime ujë, e pak më larg prej tyre vërejt dy gra që po i ndalnin (kafshët e tyre) e u tha: “E çka është puna e ju të dyja-

ve?" Ato të dyja i thanë: "Ne nuk u japim ujë deri të largohen barinj të, kurse babai ynë është shumë i vjetër!" Atëherë ai u dha ujë (kafshëve) të tyre, pastaj u largua anash nën një hije e tha: "O Zoti im, unë kam nevojë për çka do që të më japësh!" (Kasas: 23-24). Me këtë veprim Musai (a.s) nevojën e tij e mbështeti tek Allahu (xh.sh) duke mos u zhgënjyer e as duke mos u dëshpëruar. Në librat e tefsirit përmendet se Musai (a.s) ishte shumë i uritur, pasi kishte tri ditë pa ngrënë gjë, por nevoja e njeriut nuk ka të bëjë vetëm me ushqimin. Kështu që kur ia shfaqti Allahut (xh.sh) nevojën e tij, iu drejtua me lutje dhe iu mbështet me gjithë qenien e tij, përgjigja ishte e pakthyeshme. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: "E njëra prej tyre erdhi te ai, ecte e turpëruar, e tha: "Babai

im të thërret të paguajë shpërblimin për atë që u dhe (bagëti-ve) ujë!" (Kasas: 25). Kjo martesë e begatshme u kurorëzua mes Musait (a.s) dhe njëres nga vajzat e Shuajbit (a.s).

Po kështu ndodhi përsëri me Musain (a.s) kur u bë peygamber, kur së bashku me besimtarët e tij u ndodhën përpara detit, ndërsa pas po i ndiqte Faraoni dhe ushtria e tij. Musai (a.s) veprimi ashtu siç vepruan të gjithë peygamberët e tjerë përpara tij, iu mbështet forcërisht Allahut (xh.sh), nuk u lëkund aspak nga frika e rrezikut edhe pse deti ishte para tyre dhe armiku prapa e as nga frika e zhdukjes së padiskutueshme. Sa që beni israilët filluan të thonë: "Na arritën Faraoni dhe ushtria e tij", por Musai (a.s) tha: "Jo, jo. Zoti im është me mua dhe Ai do të më ndihmojë". Transmetohet se pa mbaruar mirë Musai (a.s) nga lutja e tij, erdhi urdhri të godasë detin me shkop. Sapo e goditi detin në të, u hap një rrugë si lugina mes dy maleve të mëdhenj. Kështu shpëtoi Musai (a.s) dhe të gjithë ata që i besuan dhe u zhduk Faraoni së bashku me ushtrinë e tij. Si vërtetim i kësaj mbështetje (tevekkuli) kemi fjalën e Allahut (xh.sh) që thotë: "A nuk i mjafton Allahu robit të Tij. Dhe të frikësojnë ty me të tjerë përveç Allahut". (Zumer: 36)



### Mbështetja dhe pseudombështetja

(Tevekkuli dhe tevakuli)

Për njeriun që i mbështetet Allahut, ndodhin edhe gjëra të cilat dalin jashtë natyrës së shkaqeve për të cilat ne jemi mësuar t'i shikojmë. Kështu që zjarri për Ibrahimin (a.s) u bë i ftohtë dhe i padjegshëm, por edhe deti që është i frikshëm, pasi në shumë raste ka qenë shkaku i fundosjeve dhe i mbytjeve të shumë anijeve dhe njerëzve, u bë shkak shpëtimi për Musain (a.s) dhe ata që i besuan atij. Me gjithë këtë nuk lejohet që ne të lëmë ose të neglizhojmë shkaqet me pretendimin e mbështetjes (tevekkulit). Ashtu siç nuk bën dhe nuk duhet bërë që të mbështetemi plotësisht te fuqia dhe ndikimi i shkaqeve, sepse Krijuesi i këtyre shkaqeve është i plotfuqishëm që t'i ndalojë apo pezullojë ato, siç ndodhi me eksodin e madh të Musait (a.s) dhe njerëzve besimtarë të tij. Apo siç tha Ebu Bekri (r.a) kur idhujtarët rrethuan shpe-

*Nuk lejohet që ne të lëmë ose të neglizhojmë shkaqet me pretendimin e mbështetjes (tevekkulit). Ashtu siç nuk bën dhe nuk duhet bërë që të mbështetemi plotësisht te fuqia dhe ndikimi i shkaqeve, sepse Krijuesi i këtyre shkaqeve është i plotfuqishëm që t'i ndalojë apo pezullojë ato,...*

llën në të cilën ishte fshehur së bashku me Pejgamberin (a.s): “Sikur ndonjëri prej idhujtarëve të shikonte nga këmbët e tij, ata do të na kishin parë”. Ndërsa Pejgamberi (a.s) tha: “Çfarë mendon ti për dy veta dhe i treti është Allahu. Mos u mërzit, Allahu është me ne”. Allahu (xh.sh) thotë në Kur’an: “Mos u pikëllo (friko), Allahu është me ne!” E Allahu zbriti qetësi (në shpirtin e) atij, e fuqizoi me një ushtri që ju nuk e patë; e fjalën e atyre që nuk besuan e bëri më të ultën, kurse fjala e Allahut (është) më e larta. Allahu është më i fuqishmi, më i urti”. (Tevbe: 40)

Mosvlerësimi dhe neglizhenca në kapjen dhe marrjen e shkaqeve është cenim i shëriatit. Dijetarët e kanë shpjeguar mbështetjen (tevekkulin) duke thënë: “Le të bësh punën



tënde, pastaj shiko në qiell”. Transmeton Enes ibn Maliku (r.a) se një njeri i tha Pejgamberit (a.s): “O i Dërguar i Allahut! Ta lidhi devenë dhe të mbështetem tek Allahu, apo të mos e lidhi devenë dhe të mbështetëm tek Allahu? Pejgamberi (a.s) i tha: “Lidhe devenë dhe mbështetu tek Allahu”. (Tirmidhiu). Ndërsa mosvlerësimi dhe lënia e shkaqeve nuk ka të bëjë aspak me mbështetjen (tevekkulin), por ai është tevakul (pseudombështetje) për të cilin na ka tërhequr vëmendjen Pejgamberi (a.s). Mbështetjen tek Allahu e çmojnë të gjithë, të mëdhenjtë dhe të vegjlit, burrat dhe gratë. Transmetohet se një njeri hyri në xhaminë e Pejgamberit (a.s) dhe shikoi një fëmijë duke u falur gjatë. Kur mbaroi faljen i tha: “Djali i kujt je?” Fëmija tha: “Jam jetim, nuk kam as nënë as baba”. Burri i tha: “A pranon të jem babai yt?” Fëmija i tha: “A më ushqen kur të kem uri?” Tha: Po. A më gjen rroba kur unë të kem nevojë për to? Tha: Po. A më shëron kur të jem i sëmurë? Burri i tha: “Kjo nuk është në dorën time”. Fëmija i tha: “A më ngjall kur të vdes?” Tha: “Kjo gjë nuk i përket askujt prej krijesave. Atëherë fëmija i tha: “Më lër mua tek Ai që më krijoi dhe Ai do të më udhëzojë, më ushqen e më jep të pijë, më shëron kur të sëmurem dhe tek i Cili shpresoj të më mëshirojë dhe të më falë ditën e llogarisë. Burri tha: “Allahut i kam besuar. Kush i mbështetet Allahut, Ai i mjafton atij.”

Transmetohet nga Pejgamberi (a.s) se ai ka thënë: “Si-

kur ju të mbështeteshit tek Allahu ashtu siç e meriton të mbështetesh tek Ai, Allahu do t’ju furnizonte siç i furnizon shpendët, të cilat në mëngjes fluturojnë të uritura dhe në darkë kthehen të ngopura”. (Transmeton Imam Ahmedi dhe Tirmidhiu). Prej lutjes së Pejgamberit (a.s) ka qenë edhe kjo dua: “O Zoti im! Unë Ty të jam drejtuar, punët e mia te Ti i kam deleguar, gjithë qenien time, me dëshirë dhe me pahir, te Ti e kam mbështetur. Nuk ka strehim dhe as shpëtim përveç se te kthehemi te Ti”. (Transmeton: Buhari dhe Muslimi). Gjithashtu thoshte: “O Zoti im! Te Ti jam dorëzuar, Ty të kam besuar, Ty të jam mbështetur, te Ti jam kthyer dhe vetëm te Ti drejtohem për çdo gjë që kam nevojë. O Zoti im! Me madhërinë Tënde mbrohem prej humbjes. Ti je i Gjalli që nuk vdes kurrë, ndërsa xhinët dhe njerëzit vdesin”. (Transmeton Muslimi).

Pejgamberi (a.s) ishte i bindur se asgjë tjetër përveç Allahut (xh.sh) nuk mund të sjellë dëm ose dobi. Madje një ditë Pejgamberi (a.s) mori për dore një njeri të sëmurë me lebrozë (sëmundje lëkure) dhe u ulën të dy të hanë së bashku, pastaj i tha: “Ha i bindur tek Allahu dhe duke iu mbështetur plotësisht Atij”. (Transmeton Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe).

### Mbështetja tek Allahu është gjysma e fesë

Të gjithë njerëzit duhet të mbështetën tek Allahut (xh.sh) dhe të vlerësojnë e të kapen për shkaqe të lejueshme. Ibn

Kajjim për tevekkulin (mbështetjen) ka thënë: “Tevekkuli (mbështetja) është gjysma e fesë, ndërsa gjysma tjetër është të kthyerit tek Allahu, sepse feja është kërkimi i ndihmës dhe adhurimi. Tevekkuli (mbështetja) është kërkimi i ndihmës dhe të kthyerit tek Allahu është adhurimi”. Gjithashtu ka thënë: “Tevekkuli (mbështetja) është prej shkaqeve më të forta me të cilat njeriu largon rreziqet, zullumet dhe padrejtësitë e ndryshme të shkaktuara nga njerëzit”.

Seid ibn Xhubejri ka thënë: “Tevekkuli (mbështetja) tek Allahu (xh.sh) është bashkimi me besimin (imanin)”.


Transmetohet nga Ibn Abbasi (r.a) se ai ka thënë: “Banorët e Jemenit gjatë pelegrinazhit të tyre për në Mekke nuk merr-

nin me vete ushqim dhe plaçka të nevojshme për udhëtim dhe thoshin: “Ne jemi mbështetur tek Allahu”. Por kur arrinin në Mekke kërkonin furnizim prej njerëzve. Atëherë Allahu (xh.sh) zbriti fjalën e Tij: “...dhe përgatituni me furnizim (për rrugë), e furnizimi më i mirë është devotshmëria...” (Bekare: 197)

Transmetohet se Musai (a.s) i drejtohej Allahut (xh.sh) me këtë lutje: “O Zoti im, Ty të takon falënderimi, Ty të ankohe mi, te Ty kërkojmë ndihmë dhe te Ti kërkojmë begati. Vetëm te Ti është mbështetja. Nuk ka forcë e fuqi përveç Teje. O robër të Allahut, vetëm Allahu është Mbështetësi tek i Cili dikush mund të mbështetet. Të gjitha çështjet tek Ai i mbështetni, në mënyrë që të keni dobi dhe të largoni të keqen”.

### **Mbështetësi, prej emrave të Pejgamberit (a.s)**

Prej emrave të Pejgamberit (a.s) është edhe emri “mbështetësi”, siç ka ardhur edhe në hadith: “Të kam quajtur mbështetësi”. Kjo sepse Pejgamberi (a.s) ishte tejet i bindur në lehtësi dhe me durim në gjërat e padëshiruara të cilat e goditnin. Ai me zemër të sinqertë mbështetej vetëm tek Allahu dhe te askush tjetër (xh.sh) që të fitonte të mirat dhe të largonte të këqijat. Prandaj në të Dërguarin tonë (a.s)



ne kemi shembullin më të mirë e më të përsosur, sepse patjetër duhet bindje e fortë dhe shpresë e madhe në atë që është tek Allahu (xh.sh), ndërsa për atë që është në duar e njerëzve ne duhet të dëshpërohemi. Atë që ke tek Allahu ta konsiderosh më të sigurt se sa atë që ke në dorën tënde, sepse, a ka njeri që i ka kërkuar Allahut diçka e Ai të mos ia ketë dhënë? Ta ketë lutur Allahun e Ai të mos jetë përgjigjur? Të jetë mbështetur tek Allahu e Ai të mos ketë mbrojtur, apo të ketë qenë i sigurt në ndihmën e Allahut e Ai ta ketë zhgënjyer?

Njeriut nuk i vjen e keqja përveçse nga vetja e tij dhe prej mendimit të keq që mund të ketë. Në hadith kudsij thuhet: “Unë jam te mendimi i robit Tim për Mua, prandaj le të mendojë për Mua çfarë të dojë”.

Shpërblimi vjen sipas punës. Prandaj keni mendimin e mirë për Zotin tuaj dhe mbështetuni tek Ai që të shpëtoni, sepse Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.

*A ka njeri që i ka kërkuar Allahut diçka e Ai të mos ia ketë dhënë? Ta ketë lutur Allahun e Ai të mos jetë përgjigjur? Të jetë mbështetur tek Allahu e Ai të mos e ketë mbrojtur, apo të ketë qenë i sigurt në ndihmën e Allahut e Ai ta ketë zhgënjyer?*

# Lutjet nga Kurani

“Dhe na i prano pendimet tona, se Ti me të vërtetë je Pranues i pendimeve dhe i Mëshirshëm”



(Bekare:128)

“O Zot më bën falës të namazit dhe prej pasardhësve të mi bën të tillë, dhe, o Zot, pranoje lutjen”



(Ibrahim: 40)

“Zoti im, më dhuro (dituri për) pushtet dhe më bashko me të mirët, më le përkujtim të mirë ndër ata që vijnë pas, më bën prej trashëguesve të Xhennetit të begatshëm”



(Shuara: 83-85)

“Zoti ynë, mos na bëjë sprovë për ata që mohojnë dhe na fal neve, Ti je Ngadhënyesi, I Urti”



(Mumtehine: 5)

“O Zot, më mundëso që Të të falënderoj për të mirat Tuaja që na i dhurove mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira që Ti i pëlqen, e me mëshirën Tënde më fut në mesin e robërve Tuaj të mirë”



(Neml: 19)

“O Zot, më fal nga ana Yte pasardhës të mirë, vërtet, Ti je Dëgjues i lutjes”



(Ali Imran: 38)

“O Zot, mos më le të vetmuar, se Ti je trashëguesi më i miri (pas çdokujt)”



(Enbija: 89)

“O Zot, ma zgjero gjoksin tim, ma lehtëso këtë punë timen, më zgjidh nyjen e gjuhës sime, që ta kuptojnë fjalën time”



(Taha: 25-28)

“O Zot, unë i kam bërë padrejtësi vetvetes, për këtë më fal mua”



(Kasas: 16)

“O Zot, mos na bën sprovë për zullumqarët dhe na shpëto me mëshirën Tënde nga jobesimtarët”



(Junus: 85-86)

“Zoti ynë, na i fal mëkatet tona dhe lëshimet në punët tona, na i forco këmbët tona dhe ndihmona kundër popullit jobesimtar”



(Ali Imran: 147)

“Zoti ynë, na dhuro nga ana Jote mëshirë dhe na përgatit udhëzim të drejtë në të gjitha çështjet tona”



(Kehf: 10)

“O Zot, më shto (edhe më tepër) dituri”



(Taha: 114)

“O Zot, kërkoj strehim te Ti prej nxitjeve të djajve dhe kërkoj strehim te Ti që ata të mos më afrohen”



(Muminun: 97-98)

“O Zot, më fal dhe më mëshiro, se Ti je Mëshiruesi më i mirë”



(Muminun: 118)

“Zoti ynë, na jep në këtë botë të mira, e edhe në ahiret na jep të mira dhe na mbroj nga dënimi i zjarrit”



(Bekare: 201)

“Dëgjuam dhe respektoam, dhe prej Teje kërkojmë falje o Zoti ynë, ngase te Ti është përfundimi”



(Bekare: 285)

“Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona pasi na udhëzove, na dhuro nga ana Jote mëshirë, se vetëm Ti je Dhurues i madh”



(Ali Imran: 8)

“Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i Lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit! Zoti ynë, atë që Ti e fut në zjarr, atë e ke poshtëruar; për zullumqarët nuk ka ndihmëtarë! Zoti ynë, ne dëgjuam një thirrës që ftonë për besim (e thoshte): Besoni Zotin tuaj! E ne besuam! Zoti ynë, na i fal mëkatet tona, na i shlyej gabimet tona dhe pas vdekjes na bashko me të mirët! Zoti ynë, jepna atë që nëpërmjet Të dërguarve T'u na e premtove dhe në Ditën e Kijametit mos na turpëro; vërtet, Ti je Ai që nuk e shkel premtimin”



(Ali Imran: 191-194)

“O Zot, më mundëso që Të të falënderoj për të mirën Tënde që ma dhurove mua dhe prindërve të mi, që të bëj vepra të mira që i pëlqen Ti dhe m'i bën të mirë pasardhësit e mi. Unë pendohem te Ti dhe unë jam prej muslimanëve”



(Ahkaf: 15)





# Paracaktimi hyjnor dhe enigmat e tij

**T**ë gjitha ndodhitë dhe ngjarjet në gjithësi, që nga grimca deri tek rruzulli, që nga bërthama deri tek gjithësija, që nga mikro dhe makro botët deri tek normo bota në ardhmëri, janë paraprogramuar deri në imtësinë më të vogël rreth kohës, vendit, formës dhe shkakut nëpërmjet paracaktimit hyjnor (kader) dhe kur vjen çasti i tyre do të realizo-

hen sipas programit praktik hyjnor (kaza), të cilët që të dy sendërtohen në jetën e krijesave me një madhësi që i ka hije vetëm audiencës hyjnore.

Allahu i Lartësuar i krijon krijesat duke u paracaktuar atyre edhe një kader në përputhje me të cilin ata shkojnë jetën e tyre. Shenjat e ngjarjeve të jetës janë në të vërtetë vijat që heq kaderi për çdo krijesë. Në përmbajtjen e këtij programimi prej kaderi përfshihet edhe rrugetimi i hënës, diellit, yjeve, bimëve, njerëzve, kafshëve, me pak fjalë, i të gjithë krijesave. Edhe gjethja që këputet nga dega dhe bie në tokë nuk e realizon këtë udhëtim të saj e përjashtuar nga ky programim hyjnor. Po qe se krijesat nuk do t'i nënshtroheshin programit të kaderit, në gjithësi do të sundonte një anarki e vërtetë.

Çdo vepër e artit formësohet në varësi të mundësive dhe forcës krijuese të artistit. Fjala vjen, një piktor i jep formë tablosë së tij sipas vullnetit dhe aftësive që zotëron, gjithashtu kjo vlen edhe për një kaligraf dhe bukurshkrimin që del nga duart e tij. Edhe Allahu, i ka paracaktuar dhe programuar me anë të vullnetit të Tij hyjnor që në eternitet vërshimet e fuqisë hyjnore që do të ekspozohen në gjithësi që nga krijimi i saj e deri në shkatërrimin final, enigmat dhe urtësitë që fshihen brenda njeriut, kësaj vepre madhështore të artit hyj-





*“Ne çdo gjë e krijuam sipas një mase (kader)”*

*(el-Kamer, 49)*



nor, dhe veçoritë që do të zotërojnë krijesat e tjera që nga lindja dhe deri në zhdukjen e tyre nga skena e kësaj jete.

Ja pra, **kader** quhet natyra dhe forma e këtij rregulli që është produkt i vullnetit hyjnor. Këtë të vërtetë Allahu (xh.sh.) e shpreh kështu në ajetet e Kuranit:

**“Ne çdo gjë e krijuam sipas një mase (kader)!”** (el-Kamer, 49)

**“Asnjë nga fatkeqësitë që përjetoni ju në këtë jetë nuk ka shpëtuar pa u shkruar më parë në një libër, para se ne ta krijojmë atë. Nuk ka dyshim se Allahu e kat ë lehtë ta realizojë një gjë të tillë.”** (el-Hadid, 22)

Shkurtimisht, “kader” quhet e vërteta që Allahu i di ngjarjet që do të ndodhin shumë më përpara, i ka programuar ato sipas një rregulli dhe i ka regjistruar në librin që quhet tabela e kujtesës (levhu’l-mahfudh), ndërsa “kaza” quhet realizimi në këtë botë i ngjarjeve të paracaktuara nga ana e Allahut.

Dijenja e Allahut me anë të atributit të Tij “dituri” rreth ngjarjeve që do të ndodhin është rezultat i domosdoshëm i hyjnisë së Zotit. Fakti që Allahu, i pastër nga kufizimet kohë dhe hapësirë, e zotëron një dije të tillë është shumë e natyrshme, sepse kushtet që ia bëjnë të vështirë njeriut konceptimin e kaderit dhe

kazasë nuk ekzistojnë tek Ai.

Të besosh seç do gjë në gjithësi realizohet dhe ngjan sipas vijës së pendës hyjnore është domosdoshmëri. Kaderi është është një e vërtetë që të gjithë e kanë pranuar me unanimitet. Edhe mosbesimtarët madje e kanë pranuar pa shprehur asnjë kundërshtim ndikimin e një fuqie që vepron mbi forcat e njeriut duke e emërtuar këtë të vërtetë me fjalën “fat”, duke treguar se qoftë edhe në mënyrë të pandërgjegjshme e pranojnë të vërtetën që feja e quan “kader”.

Por ashtu sikurse është e pamundur t’i përshkruhen një të verbëri ngjyrat dhe llojet e tyre, po aq e pamundur është që me anë të perceptimit njerëzor, i cili mendon në varësi të përshtypjeve që merr nga bota e jashtme dhe varet nga kufizimet kohë dhe hapësirë, të mund të shkrihem si dhe sa duhet në të fshehtë e madhe të kaderit dhe kazasë. Kjo situatë mbështetet mbi urtësinë hyjnore që i pengon njerëzit të bien brenda humbjes së prehjes mendore duke u përfshirë në të fshehta që nuk mund t’i përballojnë psikikisht.

Me të vërtetë, Allahu, e ka lënë të panjohur kaderin për të gjithë krijesat dhe ua ka bërë të pamundur atyre ta mësojnë atë përpara se të sendërtohet në këtë jetë nëpërmjet shndërimit në kaza.



Si domosdoshmëri e mëshirës së pafund të Allahut, kaderi do të mbetet një mur i pakalueshëm përpara njeriut. Por si rezultat i favorit hyjnor ekzistojnë disa situata përjash-tuese në të cilat kalohet ky mur dhe mund të kundrohët përtej tij, në formën e kerameteve, nëpërmjet ëndrrave të vërteta. Janë përjetuar momente kur robërit e mirë tek Zoti, të kenë parë në ëndërr gjëra që janë vërtetuar më pas në jetë. Këto situata janë shkëndija që përçohen tek ta prej “levhu’l- mahfudhit”.

E drejta e përzgjedhjes që zotëron njeriu për të kryer vepra të mira apo të këqija, pozitive apo negative quhet “vullneti i pjesshëm” (iradetu’l-xhuzi). Vullneti i plotë (iradetu’l-kuli) i takon vetëm Allahut. Kjo është arsyeja që për njeriun është e pamundur liria absolute. Lindja, vdekja, jetëgjatësia, seksualiteti, kombësia dhe aftësitë janë veçori mbi të cila njeriu nuk ka të drejtë përzgjedhjeje, por që përfshihen brenda kaderit absolut. Njeriu, domosdoshmërisht, nuk është përgjegjës rreth tyre.

Allahu e cilëson përgjegjës njeriun në varë-

si të mundësive që i dhuron atij. Për këtë arsye, për aktet që ndodhin përjashta vullnetit njerëzor, nuk bëhet fjalë as për dënim, as për shpërblim hyjnor. Kjo është arsyeja përse njeriu që ha ose pi ndërsa është agjërueshëm, pa qenë i vetëdijshëm për atë që është duke bërë, nuk e prish agjërimin e tij dhe për këtë arsye ndaj tij nuk do të merret asnjë dënim hyjnor në botën tjetër.

Si rezultat i faktit që njeriu është përpara një provimi dhe përgjegjës për veprimet e tija, Allahu ka vendosur brenda tij bazat e devotshmërisë dhe mëkatshmërisë (fisk) dhe i ka njohur atij të drejtën e përzgjedhjes së përdorimit të vullnetit të tij si për mirë, ashtu edhe për keq. Ashtu sikurse edhe thuhet në ajetin fisnik të Kuranit se “Allahu e quan përgjegjës çdo njeri në masën që ai ka mundësi dhe fuqi të kryejë diçka...” (el-Bakara, 286), pra njeriu nuk është ngarkuar me përgjegjësi që e tejkalojnë fuqinë e tij. Por njëkohësisht çdo njeri është cilësuar përgjegjës aq sa ai ka fuqi dhe forcë të kryejë. Të mos kryesh si duhet ato akte që njeriu ka fuqi t’i kryejë dhe t’i vishet

faji kaderit është fryt i injorancës dhe indiferencës së njeriut.

Ndërsa vullneti hyjnor gjendet pas çdo ngjarjeje dhe ndodhie në këtë gjithësi, pëlqimi i Tij ndodhet vetëm mbi veprat e mira. Synimi i një mësuesi është që nxënësit e tij të kalojnë klasën me sukses, por në qoftë se nxënësi as që do t'ia dijë ç'është mësimi dhe nuk mëson atëherë mësuesi nuk ka asgjë çfarë t'i mësojë atij nxënësi. Në të njëjtën logjikë, detyra e mjekut është që ta shërojë të sëmurin, por në qoftë se pacienti nuk vepron sipas recetës mjekësore, atëherë vetëm ai është përgjegjës për pasojat negative në këtë rast dhe asnjë faj nuk mund t'i ngarkohet doktorit.

Fjalët "Ç'të bëj?! Kështu paska qenë fati im!" që shpreh personi që shkon në një udhë të mbrapshtë janë vetëm rezultat i indiferencës shpirtërore të tij. Prandaj prirja e njeriut për të dalë i larë duke fajësuar kaderin, është një padrejtësi që kryhet ndaj të vërtetës dhe drejtësisë hyjnore.

Në ajetet kuranore Allahu (xh.sh.) thotë:

"Nuk ka asnjë dyshim që Allahu nuk e trajton me padrejtësi askënd, qoftë edhe një grimcë..." (en-Nisa, 40)

"Fatkeqësia që përjetoni është për shkak të akteve dhe veprimeve që kryeni. Allahu e fal dhe mëshiron shumicën e gjynahqarëve." (esh-Shura, 30)

Mevlana e shpreh me këto fjalë në veprën e tij Mesnevi, gati si të jetë duke bërë komentimin e këtyre ajeteve, që njerëzit janë përgjegjës për veprimet e tyre në masën e vullnetit të pjesshëm (iradetu'l-xhuzije) dhe se ata nuk duhet të fajësojnë kaderin për mëkatet që kryejnë:

*"Po qe se të ngulet një gjemb, dije se atë gjembishte e ke mbjellë vetë! Po qe se në trup mban të veshur stof të butë dhe të lehtë dije se atë e ke endur me duart tuaja!"*

Rrezja e dëgjimit për veshin dhe ajo e shikimit për syrin kanë një kufi të caktuar. Në qoftë se distanca mes këtyre organeve dhe ob-

jektit që perceptohet prej tyre është aq i gjatë sa ta kalojë kufirin e caktuar është e pamundur të dëgjosh ose të shikosh. Në këtë kontekst konceptimi si dhe sa duhet i çështjeve të kaza-së dhe kaderit e tejkalojnë potencialin e të kuptuarit njerëzor, sepse njeriu përpiqet t'i njohë dhe zgjidhë dukuritë dhe fenomenet në sajë të lidhjes logjike shkak-pasojë, duke mos arritur ta perceptojë në të shumtën e rasteve urtësitë që qëndrojnë pas atyre dukurive apo fenomeneve. Ja se si iu përgjigj Aliu (r.a.) personit që e pyeti rreth enigmës së kaza-së dhe kaderit:

*"Ajo temë është një oqean i pamat dhe i thellë!"*

Personat që i besuan inteligjencës së tyre dhe u kredhin në ujërat e atij oqeani mbetën të mbërthyer brenda vorbullave, ashtu siç pat ngjarë me "xhebritë" që mbronin pikëpamjen se njeriu nuk zotëron as shkallën më të vogël të vullnetit të lirë, apo si "kaderit" që mendonin se njeriu posedon vullnet absolut në lidhje me çdo çështje. Dhe në fund fare ata do të mbyten në atë oqean të pamat dhe të breg shpëtimi. Megjithëse ekziston qoftë



sadopak mundësia për të kaptuar pikërisht nga pika, ku inteligjenca dhe perceptimi nuk mund të rrokin më shumë, drejt kuptimit të kësaj të vërtete hyjnore nëpërmjet nënshtrimit me shpirt dhe zemër ndaj Allahut, është jash-tëmendësh që të kuptuarit e njeriut të arrijë ta zbërthej në mënyrë absolute enigmën e kë-tyre të vërtetave. Ta kuptosh, të dish se deri ku shkon kufiri njerëzor dhe të mos këmbë- ngulësh të kuptosh përtej asaj që është e pa- mundur për mendjen e njeriut është rrjedhojë e nënshtrimit të përmbushur të njeriut ndaj Zotit.

Shpesh herë ndodh që njeriu të kërkojë me ngulm plotësimin e gjërave që nuk janë të mi- rën e tij. Ndoshta ajo që kërkoj të arrijë në të vërtetë është rruga që e shpie drejt asgjësisimit. Njeriu që ka një fund të tillë nuk do ta për- mbajë vetveten nga rënkimet e pendesës, me- gjithëse në fillim ai e dëshiroi si rezultat i in- diferencës shpirtërore realizimin e një gjëje në jetë. Kjo është arsyeja që mundësia e vetme për të shtënë në dorë gjërat që të falin prehjen në këtë botë dhe lumturinë në botën tjetër arrihet duke e rrokur me mendje këtë madhështi hyj- nore dhe duke iu nënshtruar caktimit hyjnor. Aftësia e njeriut për të konceptuar mosqenësi- në e tij përbën kapitalin e tij të përjetësisë. Pra zgjidhja e vetme përballë kazasë dhe kaderit është nënshtrimi ndaj Zotit, sepse tevekul dhe nënshtrimi ndaj Zotit janë portat e mëshirës që e përmirësojnë kaderin.

I dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë:

*“Besimi në caktimin e Zotit është garanci ndaj çdo lloj problemi jetësor.”*

Përbën gabim fatal të kuptuarit e kënaqësi- së, nënshtrimit dhe mbështetjes me caktimin hyjnor si një gjendje përtacie dhe pacifizmi, të kuptuar që shprehet nëpërmjet mosmarrjes së masave parandaluese dhe mosangazhimi në parandalimin e fatkeqësive të mundshme në jetë. Tevekul do të thotë t’i dorëzohesh Alla- hut dhe të strehohesh tek Ai pasi t’i kesh marr masat për realizimin e veprës së mirë dhe shmangien apo zhdukjen e gjërave të dëm- shme. Një ndjenjë tevekul e thatë pa i parë shkaqet e atyre që ngjajnë përreth nesh është e papranueshme, sepse para së gjithash ajo bie ndesh frymën e tevekullit të vërtetë.

Omeri (r.a.) teksa udhëtonte për në një de- stinacion të caktuar mëson se ndalesa në vazhdim, në qytetin e Damaskut, është për- hapur një sëmundje ngjithëse. Pasi u këshillua me shokët e tij ai vendos që të heqin dorë nga vizita në qytetin e Damaskut. Megjithëse ky vendim i Omerit që në përputhje me urdhrin e Profetit, njëri nga sahatet Ebu Ubejde bin Xherrah i pati drejtuar këtë pyetje Omerit:

- A jemi duke u përpjekur t’i shmangemi caktimit të Zotit? Kësaj pyetjeje Omeri i që përgjigjur me këto fjalë:

*“- Po, po arratisemi nga caktimi i Zotit për t’u strehuar tek caktimi i Zotit.”* (Buhari, Tib, 30)

Sikur se shihet edhe në këtë përgjigje të Omerit (r.a.) nuk mund të dilet përjashta ku-



fijve të kaderit. Për këtë arsye njeriut i takon vetëm të marra masa dhe të përpiqet që punët të marrin kahun pozitiv në rrjedhën e jetës, ndërsa në fund fare të jetë i kënaqur me caktimin hyjnor.

Për mendjet dhe sytë e besimtarëve të devotshëm, që i shohin gjërat nga dritarja e urtësisë hyjnore, enigmatika që qëndron e fshehur brenda kaderit dhe fakti që njeriu nuk arrin ta kuptojë atë sa duhet nuk është arsye e një shtrydhjeje mendore dhe shpirtërore tek njerëzit, por, përkundrazi, është një favor jashtëzakonisht i madh për njeriun nga ana e Zotit, sepse në rast se njeriu do ta kuptonte kaderin, kjo do të bënte që ai të gjendej i zhytur brenda rreziqesh dhe fatkeqësish të mëdha shpirtërore.

Për ta ilustruar këtë që sapo thamë mund të marrim si shembull një person që do të jap shpirt si pasojë e një sëmundjeje e cila nuk ka shërimi. Vetëm në sajë të faktit që për të kaderi është i panjohur, ky njeri mund të jetojë me shpresë se mund të shtyjë ditë të tjera nga jeta e tij dhe nuk e mbulon tmerri i një momenti të caktuar dhe të ditur të vdekjes. Po qe se ky person do ta dinte çastin se kur do t'i vinte vdekja, atëherë atij do ti ngriheshin duar e këmbë nga ndjesia e afrimit të datës së vdekjes dhe do t'i përngjante një krijese që vdes e ngjallet vazhdimisht. Një nënë që do ta dinte se foshnja ose fëmija e tij do të vdiste para saj do të tretej si qiri nga dhimbja që do t'i shkaktonte pikëllimi i asaj dite. Si konkluzion, njohja e mëparshme e kaderit do të

shkaktonte situata që bien në kundërshtim me harmoninë e jetës dhe do të shkatërrohej ekuilibri i jetës.

Stresi, krizat mendore dhe shpirtërore, si dhe vetëvrasjet tek njerëzit që vitet e fundit janë duke u rritur në numër nuk janë gjë tjetër përveç se rezultati i natyrshëm i dobësimit që përjeton vullneti i pjesshëm (iradetu'l-xhuzije) tek njerëzit. Ato janë edhe një pasojë e dhimbshme që shkaktohet nga zbrazëtia shpirtërore, sepse një zemër që rreh duke qëndruar larg edukimit shpirtëror, natyrisht që do të kthehet në skllav të dëshirave dhe epsheve për këtë botë. Besimi në kader që e udhëheq njeriun drejt "gajbit" do të thotë një jetë e shkuar me nënshtimin që i mirëpret i qetë surprizat e jetës.

Parimi i pandryshueshëm i lumturisë është nënshtimi i inteligjencës përpara vajit, stolisja me një moral të mirë të zemrës dhe shprehja e durimit ndaj surprizave të jetës. Lumturia e vërtetë në këtë jetë do të thotë të pranosh baticat dhe zbaticat e jetës, të durosh vështirësitë që të shkaktojnë ato, të shohësh anën e mirë në çdo gjë dhe t'i nënshtrohesh Zotit të botëve.

Zoti ynë! Na bëj nga besimtarët që mbështeten vetëm tek Ti ashtu siç e meriton Ti dhe na mundëso të kryejmë vepra në përputhje me kënaqësinë Tënde!

Amin!



# Lehtësia e mbështetjes në Allahun xh.sh.

**S**ecili njeri ndodhet në disa situata “të pakëndshme”, “të papërshtatshme”, dhe “të pa fat”. Këto situata gjatë jetës ose mund të jenë të vogla që njeriu i përjeton gjatë ditës, ose mund të jenë aq të mëdha saqë mund

të ndikojnë negativisht në mbarrë jetën e tij. Njerëzit që nuk jetojnë me moralin e Kur’anit kur të përballohen me këso lloj situatash të vogla apo të mëdha që nuk i pëlqen epshi i tyre, ndjejnë shqetësim, lodhje, brengosje, tendosje dhe frikë. Ndërkaq kjo në të vërtetë është një torturë që njerëzit ia shkaktojnë vetvetes, në fundin e asaj që jetojnë, të pa informuar për një të vërtetë shumë të rëndësishme. Siç tregohet edhe në Kur’an, Allahu nuk i torturon njerëzit por njerëzit e torturojnë vetveten. Nëse ata që nuk kanë besuar, ose edhe pse kanë besuar, preferojnë një jetë pa i kushtuar

vëmendjen e duhur të vërtetave që i ka komunikuar Allahu në Kur’an, gjithmonë do të jetojnë brenda shqetësimeve, brengave, frikësimeve, mundimeve po edhe në të njëjtën kohë do të kenë edhe shumë dobësi dhe dhimbje shpirtërore.

Në këtë dynja nuk do të ketë arsye që të jetojnë të brengosur, të shqetësuar, dhe të frikësuar ata njerëz që ua vënë mendjen të vërtetave që ka porositur Allahu në Kur’an, sepse ata që kanë besuar, e dinë se çdo gjë që ndodhë është e shkruar (e regjistruar) në librin e quajtur “Levhi-i Mahfudh” dhe se të gjithë njerëzit tjerë edhe vetë janë ndjekës të kaderit (caktimit të Zotit). Si rrjedhojë e kësaj ata nuk harrojnë asnjëherë se situatat që i ka krijuar Allahu çdo herë do të përfundojnë në të mirë për ta dhe se Allahu kaderin e robërve të devotshëm e ka krijuar në mënyrën më të mirë dhe më të përshtatshme ndaj tyre.

Një pjesë e njerëzve kaderin e dinë pak a shumë, mirëpo përsëri në lidhje me të kanë percep-

tim të gabuar. Për shembull në kaderin e njeriut mendojnë se është vetëm personaliteti dhe fizionomia e tij (flokët, fytyra, gjatësia e shtatit, duarve...). Kurse çështjen e fitimit të parave, fitimit të profesionit, humbjen e pasurisë, ndodhjen e fatkeqësisë... nuk e mendojnë pjesë të kaderit. Dhe për këtë arsye mendojnë se do ta ndryshojnë atë. Shumë herë në mesin e rrethit tonë ku jetojmë i dëgjojmë njerëzit duke thënë: "Ah, sikur mos të kishte bërë kështu, nuk do t'i ndodhte kjo apo ajo", "Ah, sikur mos të dilte në rrugë, nuk do të bënte aksident...". Këto janë fjalë që i thonë njerëzit që nuk e kanë shijuar ëmbëlsirën e besimit, sepse në kaderin e njeriut është e caktuar e gjithë jeta, të gjitha situatat që përjetojnë gjatë gjithë jetës, çdo bisedë, çdo çast, çdo shikim, çdo zë etj. Për shembull; ju sido që të jetë leximin e këtyre rreshtave në këtë çast, në këtë orë, e keni pasur në kader. Kurse Allahu këtë çast e ka ditur me miliarda vite përpara se t'ju krijonte. Ndoshta ju derisa jeni duke i lexuar këta rreshta keni përjetuar shumë gjëra. Për shembull: Mu në kohën kur filloni të lexoni, dëgjoni se në derë po troket dikush. Kur e hapni derën e vëreni shokun tuaj. Në këtë mënyrë leximin e leni për më vonë. Kështu që trokitja e derës mu në kohën kur keni filluar të lexoni, thënia e shokut tuaj fytyrë qeshur "mirëdita" pas hapjes së derës, lërja për më vonë e leximit dhe të gjitha bisedat, fjalët, shakatë, qeshjet që kanë kaluar gjersa keni qëndruar bashkë me shokun tuaj, ju ende pa i përjetuar këto, në dijeninë

e Allahut kanë qenë të ditura para miliarda viteve. Allahu këtë e tregon kështu:

**Ti nuk angazhohesh me asnjë çështje, nuk lexon nga ai pjesë nga Kur'ani dhe nuk bëni ndonjë vepër, vetëm se ne jemi prezantuesit tuaj, kur ju ndërmerrni atë. Zotit tënd nuk mund t'i fshihet as në tokë e as në qiell as sa grimca e as më e vogël se ajo e as më e madhe, por vetëm sa është evidentuar në librin e sigurt. (Junus, 61)**

Allahu është larg vendit dhe kohës. Kurse ai që i përket vendit dhe kohës është njeriu. Për këtë arsye e kaluara jonë, ky çast dhe e ardhmja jonë te Allahu është një çast që ka ndodhur dhe përfunduar. Për shembull: Dita tjetër e jetës tonë është një çast e cila do të vijë për ne. Kurse në të vërtetë ai çast te Allahu ka ndodhur dhe përfunduar. Andaj Allahu tani është duke e ditur se çka do të vishni nesër, se çka do të shkruani nesër, se me kë do të takoheni nesër, se çka do të bëni gjatë gjithë ditës së nesërme. Në të njëjtën mënyrë edhe tani është duke e ditur se çka do të bëni pas një viti, pas dy viteve, pas pesë viteve, pas dhjetë viteve, pas tridhjetë viteve, pas pesëdhjetë viteve. Kështu që Allahu në këtë çast është duke e ditur të gjitha ditët, detajet më të imëta madje edhe minutat dhe sekondat e të gjithë atyre njerëzve që kanë jetuar që nga Ademi a.s e deri

*Një njeri i cili e bënë mik dhe mbrojtës të vetes së tij Allahun, është i kënaqur në çdo situatë që e ka krijuar Miku dhe Ndihmuesi i tij më i mirë, Allahu Fuqiplotë.*

më tani po edhe të gjithë atyre njerëzve që do të jetojnë që nga tani e tutje deri në ditën e Kiametit. Allahu si kohën e gjatë si kohën e shkurtër e ka krijuar në një çast.

Kurse është një lehtësi dhe dhunti e madhe për njeriun që e di se dituria e Allahut është e pakufizuar dhe nga ana tjetër është ndjekës i kaderit. Një besimtar i cili ka besuar me zemër të plotë dhe i është dorëzuar me sinqeritet Allahut, duke marrë mësim prej kaderit që është përgatitur për veten e tij, duke e përkujtuar me falënderim në çdo çast Allahun Lavdiplotë, e ndjekë kaderin e vet me një qetësi dhe siguri sikur një person që ndjek një film ulur.

Një njeri i cili e bënë mik dhe mbrojtës të vetes së tij Allahun, është i kënaqur në çdo situatë që e ka krijuar Miku dhe Ndihmuesi i tij më i mirë, Allahu Fuqiplotë. Në të njëjtën kohë ky njeri është i kënaqur edhe prej kaderit të tij. Allahu për t'i sprovuar njerëzit, në kaderin e tyre mund të krijojë situata dhe pamje të llojllojshme. Vetëm se çdo situatë dhe pamje te Allahu është e fshehur dhe e planifi-



kuar deri në hollësitë më të imëta dhe këto janë sipas nivelit të asaj që do të mund t'i përballojë njeriu. Për shembull: Jusufi (a.s) edhe pse nuk ishte fajtor, u burgos dhe në burg kaloi disa vite. Pa dyshim që kjo ka qenë në kader të Jusufit (a.s). Po Jusufi (a.s) ngase iu nënshtrua me gëzim dhe kënaqësi kaderit që e ka krijuar Allahu për të, burgu nuk ishte vështirësi, shqetësim, mundim, torturë, për në të kundërtën është parë si pamje dhe ngjarje që ia ka hapur derën e shumë dhuntive dhe shumë bukurive. S'ka dyshim që do të arrijë të kuptojë më shumë kënaqësinë e dhuntive një njeri që situatën e keqe apo pamjen e neveritshme e krahason me një ambient shumë të mirë, sepse edhe Jusufi (a.s) burgun pasi që e ka menduar si ambient të mirë e ka jetuar më shumë kënaqësinë e dhuntive. Sigurisht që është shumë e

ndryshme kënaqësia që merr njeriu që e sheh çdo ditë kopshin me trëndafila, me kënaqësinë e atij që me vite të tëra nuk ka parë gjë tjetër përveç murit dhe betonit. Po edhe në të njëjtën mënyrë do të marrë një kënaqësi më të madhe prej qetësisë dhe bukurisë, njeriu që e di se çka është vështirësia dhe e neveritshmja. Andaj në çdo gjë që Allahu e ka krijuar për njerëzit, ka mirësi. Allahu Lavdiplotë në Kur'an ka porositur se pas çdo vështirësie vjen lehtësimi. Ndërsa ajo që u përket besimtarëve është nënshtrimi ndaj kaderit dhe mos zemërimi i tyre përballë ndonjë situatë që shihet si e pakëndshme. Po ata që pajtohen me kaderin duhet të jenë edhe të lumtur që bëhen pjesëtarë të mundimeve dhe sprovave kur përballohen me ndonjë situatë të padëshirueshme, sepse Allahu i Gjithëdijshtëm në sajë të durimit që bëjnë njerëzit përballë asaj situatë, do t'i shpërblejë në botën tjetër.

Sigurisht besimtari që i nënshtrohet kaderit, në çdo çështje duhet të përpiqet të bëjë më tepër se ç'duhet bërë. Për shembull një person që është sëmure sigurisht që duhet të shkojë te mjeku, të kontrollohet, t'i marrë barnat, t'i nënshtrohet rregullave që thotë mjeku dhe t'i kush-

tojë kujdes çdo gjëje në lidhje me sëmundjen. Mirëpo ai e di se sëmundja, shkuarja te mjeku, trajtimi mjekësor, marrja e barnave, nënshtrimi ndaj fjalëve të mjekut, ka qenë e shkruar në kaderin e tij. Për këtë arsye asnjëherë nuk shqetësohet, pikëllohet dhe brengoset. Dhe në këtë mënyrë ai e jeton lumturinë e saj që Allahu çdo të mirë e ka krijuar për të. Besimi i njeriut se në çdo situatë ka mirësi, është një çështje shumë e rëndësishme.

Besimtarët e sinqertë i mbështeten Allahut dhe besojnë se për veten e tyre pas çdo sprove të vështirë ka lehtësi dhe mirësi. Kjo, është një veçori që vërehet vetëm te besimtarët. Pejgamberi ynë Muhamedi (s.a.v.s) këtë çështje e shpjegon kështu:

*“Sa habitëse është gjendja e besimtarit, sepse çdo punë e tij për atë është një mirësi. Kjo gjendje vërehet vetëm te besimtarët e jo te ndokush tjetër. Kur i ndodhë një gjë që atë e bënë të lumtur, falënderon. Kurse kjo është mirësi për atë, kur i ndodhë ndonjë dëm duron, kurse edhe kjo për atë është mirësi”* (Muslim, Zuhd 64,2999).

Allahu Fuqplotë është posedues i vetëm i forcës së pakufizuar dhe mbizotërues i mbarë Gjithësisë. Sido që të jetë për njeriun që e di këtë të vërtetë, nuk kërkon rrugë tjetër përveç rrugës së nënshtrimit dhe mbështetjes te Allahu Mëshirëplotë, sepse çdo situatë që përballet, çdo bisedë, çdo zë, çdo fjalë e njeriut është nën kontrollin e Allahut. Siç tregoi edhe Pejgamberi (s.a.v.s) çdo gjë që vjen prej Allahut për besimtarin, është mirësi dhe bekim.

**“Unë iu kam mbështetur Allahut, Zotit tim dhe Zotit tuaj, pse nuk ka asnjë nga gja-**





**llesat, e që Ai të mos e ketë nën sundim, vërtet Zoti im është i drejtë". (Hud, 56).**

Ata që nuk i mbështeten Allahut duke pretenduar se kanë nën kontrollin dhe forcën e tyre mbi çdo gjë, gjithmonë në shpirtrat e tyre kanë frikë, shqetësim dhe pesimizëm. Kjo është e ngjashme me emocionin, frikën dhe dhimbjen që e ndjenë njeriu gjatë shikimit të një filmi. Edhe ai me emocionin, frikën dhe dhimbjen që e ndjen, mendon sikur do të mund ta ndryshojë fundin e ngjarjes në film. Prandaj është e panevojshme dhe e pavend një frikë e tillë. Për shembull: Krijesa të Allahut janë të gjithë ata persona që përjetojnë padrejtësi nga njerëzit tjerë. Dhe Allahu i krijon këto situata vetëm për sprovimin e njeriut. Në rast se besimtari bënë durim ndaj këtyre situatave dhe shpreson fitimin e Xhenetit, mëshirës dhe kënaqësisë së Allahut, nuk ka

asnjë arsye për hidhërimin dhe shqetësimin e tij. Po edhe Allahu u dërgon ndihmë besimtarëve dhe iu siguron lehtësi në çdo punë të tyre. Ky është një premtim i prerë i Allahut Mëshirëplotë. Allahu në një ajet kuranor për ata që kanë pësuar shpifje, thotë kështu:

**"Kjo është kështu! E kush ndëshkon tjetrin me të njëjtën masë me të cilën ka qenë i ndëshkuar vetë, e pastaj atij përsëri i bëhet e padrejtë, Allahu do ta ndihmojë atë paktjetër. Allahu shlyen shumë të këqijat dhe falë mëkatet". (Haxh, 60).**

Atëherë rruga e nënshtrimit dhe mbështetjes për besimtarët që e dinë dashamirësin, ndihmën dhe forcën e Allahut është rruga e vetme, më e drejtë dhe më e lehtë. Nëse njeriu nuk e ndjekë këtë rrugë do të mbetet nën barrën e asaj që nuk do të mundë ta bartë.


Me këtë duhet të tregojmë se

ato që shprehen në thënien e djetarit në fjalë, nuk janë thënie që shprehin ngushëllimin që duhet t'i bëjmë njëri tjetrit në situatat e vështira. Por këto janë krijimet e Allahut dhe pamjet e vërteta të jetës së kësaj bote.

Andaj njeriu i injorancës gjersa e jeton shqetësimin dhe vuajtjen e mosbesimit dhe mosmbështetjes në ditët më të lumtura, besimtari i cili u beson të vërtetave, në çfarëdo kushtesh që të jetë e jeton gëzimin dhe qetësinë e lehtësisë së fesë. Allahu Lavdiplotë në Kur'an për besimtarët thotë kështu:

**"Ta keni të ditur se të dashurit e Allahut (evliatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) e as kurrfarë brengosje? (Ata janë ata) Të cilët besuan dhe ishin të ruajtur. Atyre u jepet myzhde në jetën e dynjasë dhe në jetën tjetër. Premtimet e Allahut nuk mund të pësojnë ndryshim. E, ai është sukses i madh". (Junus, 62-64).**

## Qëndrimi i dijetarëve rreth festimit të ditëlindjes së Pejgamberit a.s.



Në fenë islame janë dy festa: festa e fitër bajramit dhe festa e kurban bajramit, ndër-sa festimi i ditëve dhe datave të ndryshme historike si p.sh. festimi i ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) është vepër e lejuar, por nuk është e obliguar. Për festimin e ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) dëgjojmë shu-

më kundërshtime nga persona jo të thelluar në shkencat islame. E vërteta është se nuk kam dashur t'i qasem një problematike të tillë duke pasur parasysh se ekzistojnë shumë çështje me rëndësi që i preokupojnë myslimanët sot. Pa dyshim se ne sot jetojmë në një kohë ku armiqtë e islamit pa pushuar mundohen ta shkatërrojnë islamit dhe myslimanët si nga brenda dhe nga jashtë, pa kurrfarë mëshire. Ne sot jetojmë në një injorancë bashkëkohore ku e vërteta është kthyer në lloj plaçke që i shitet atij që ka më shumë të holla, pavarësisht se kush e blen, ndërsa gënjeshtra në kohën tonë është shndërruar në themelin e vazhdimit të proceseve të jetës.

Sot myslimanët në të katër anët e botës janë viktima të terrorit dhe gjenocidit vetëm

e vetëm pse thonë se: "Zoti ynë është Allahu". Më e keqja është se myslimanët vuajtjet e tyre i kanë edhe nga disa veprime dhe sjellje jo islame që i veprojnë disa pjesëtarë të fesë Islame, e të cilët, duke pretenduar se vetëm ata e kuptojnë Kur'anin dhe sunetin e Pejgamberit (a.s.), i japin vetes të drejtë që t'i etiketojnë dhe akuzojnë myslimanët si "mushrikë", "bidatxhinjë", "qafirë".... Më e rrezikshmja është se, edhe në mesin tonë ka të tillë që ofendojnë dhe i akuzojnë muslimanët të cilët nuk mendojnë si ata duke i quajtur bidatxhinjë, duke thënë se me ta nuk bisedohet dhe se nuk veprojnë me sunetin e Pejgamberit (a.s.) .... Të tillët pretendojnë se vetëm ata e kuptojnë dhe e jetojnë sunetin e Pejgamberit (a.s.), ndërsa të tjerët e refuzojnë sunetin e Pejgamberit (a.s.). Prandaj duke menduar se dikush edhe mund të më akuzoj se jam duke trilluar apo duke gënjyer rreth qëndrimeve të dijetarëve për festimin e ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.), kam cituar mendimet e dijetarëve duke përmendur në dipnota burimet e botuara në mënyrë që në rast dikush kërkon t'i verifikojë pohimet në këtë artikull, atëherë të ketë mundësi t'i verifikojë ato. Vërtetë ajo që më shumë i duket





ni që e feston ka shpërblim. Ata që dyshojnë rreth qëndrimit të Ibn Tejmijes (r.a.) nuk e kundërshtojnë me argumente, por me ofendime dhe akuzën se “kjo është gënjeshtër”. Ne nuk na mërzisin këto ofendime dhe akuza, por jemi të interesuar për argumentet dhe mënyrën e argumentimit që kanë shprehur dijetarët e mëdhenj islam. Duke i parë këto

rajë që të shkruaj këtë temë është se dijetari dhe shejhulislami Ibn Tejmije (r.a.) është i mendimit se lejohet festimi i ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.)

Para se të hyjë në temë dua t’i nënvizoj tri gjëra që kanë të bëjnë me ditëlindjen e Pejgamberit (a.s.) :

1. Festimi i ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) është vepër e lejuar, ashtu sikur se edhe grumbullimi i besimtarëve për të dëgjuar historinë dhe poezitë që e lavdërojnë Pejgamberin (a.s.) , gostitja me këtë rast dhe krijimi i një atmosfere të gëzueshme në mesin e besimtarëve me këtë rast.

2. Festimi i ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) nuk duhet organizuar vetëm në datën e lindjes së tij, por ai duhet përkujtuar çdo ditë dhe çdo moment, sepse është drita dhe modeli me i mirë për ne.

3. Dita e festimit të ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) duhet shfrytëzuar për t’u shpjeguar besimtarëve jetën dhe veprën e Pejgamberit (a.s.)

Dua të përmend se gjatë shtjellimit të kësaj teme unë nuk kam shprehur mendimet e mia personale, por vetëm kam përmendur

Ç’synohet me festimin e ditëlindjes?

Me festimin e ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) synohet vetë Islami, ngaqë Pejgamberi (a.s.) është shembulli praktik i Islamit. Për këtë dijetari i mirënjohur bashkëkohor Muhamed Muteveli Sharavi në librin e tij “Maide-tul Fikril Islamij”, faqe 295 thotë: “Kur i gjithë njerëzimi është gëzuar për ardhjen e Pejgamberit (a.s.) në këtë botë, pra janë gëzuar të gjitha krijesat, bimët, xhinët, bota inorganike për lindjen e Pejgamberit (a.s.), pse vallë të mos gëzohemi ne njerëzit dhe ta festojmë ditëlindjen e tij”.

Argumentet që vërtetojnë se festimi i ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) është vepër e lejuar (xhaiz)!

Përmendet në “Sahihul Buharî” se Pejgamberi (a.s.) ka përmendur se Ebu Lehebit për çdo ditë të hënë do t’i lehtësohet dënimi i zjarrit të xhehenemit për arsye se nga gëzimi i lajmit që i kishte sjellë robëresha e tij për lindjen e Muhamedit (a.s.), e kishte falur asaj lirinë<sup>1</sup>.

Disa dijetarë mendojnë se festimi për ditëlindjen e Pejgamberit (a.s.) është bërë e qartë edhe ajeti

1. Sahihu’l-Buhari, Kitabu-n-Nikah

*“Kur i gjithë njerëzimi është gëzuar për ardhjen e Pejgamberit (a.s.) në këtë botë, pra janë gëzuar të gjitha krijesat, bimët, xhinët, bota inorganike për lindjen e Pejgamberit (a.s.), pse vallë të mos gëzohemi ne njerëzit dhe ta festojmë ditëlindjen e tij”.*



58 i sures Junus: “Thuaj: Vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le t’i gëzohen...”. Sipas komentatorve të Kur’anit, mirësia më e madhe është dërgimi i Pejgamberit (a.s.) mëshirë për çdo send.

Disa dijetarë e mbështesin lejinimin e festimit të ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.), në hadithin e transmetuar nga Muslimi se, kur e kanë pyetur Pejgamberin (a.s.) rreth shkakut që ai agjëron ditën e hënë dhe të enjte, Muhamedi (a.s.) është përgjigjur: “Këtë ditë (e hënë) kam lindur dhe këtë ditë ka filluar të më vijë shpallja”.<sup>1</sup> Po ashtu ata përmendin faktin se Pejgamberi (a.s.) ka prerë kurban për ditëlindjen e tij.

Qëndrimi i dijetarit dhe shejhulislamit Ibn Tejmije (r.a.) për festimin e ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.)!

Dijetari i madh dhe shejhulislama

1. Sahihu’l-Muslim, Kitabu’s-Sijam

mi Ibn Tejmije (r.a.) ka shkruar:

(فتعظيم المولد واتخاذة موسما قد  
يفعله بعض الناس و يكون لهم فيه أجر  
عظيم

لحسن قصدهم و تعظيمهم لرسول  
الله صلى الله عليه و سلم

“Të respektuarit e ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) dhe konsiderimi i ditëlindjes së tij si festë, që disa nga njerëzit e bëjnë është vepër e cila do të shpërblehet për shkak të qëllimit të mirë të tyre dhe respektimit e dashurisë ndaj Pejgamberit (a.s.)”<sup>2</sup>

Pyesim. Pse vallë Ibn Tejmije (r.a.) me këtë pohim e ka propaganduar një bidat të tillë?! Jo, ai nuk është mjaftuar vetëm me konsiderimin e lejuar të festimit të ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.), por është shprehur se ata të cilët e festojnë atë për respekt dhe dashuri ndaj Pejgamberit (a.s.) do të shpërblehen nga Allahu (xh.sh.).

Kur lexojmë librin “Mexhmeul Fetava” pjesa 22, faqe 523, do të shohim se Ibn Tejmije (r.a.) është pyetur se ç’mendon për ata njerëz që tubohen e lexojnë Kur’an dhe e përmendin Allahun (xh.sh.) vetëm e vetëm për t’u afruar te Allahu xh.sh.? Ai është përgjigjur: “Elhamdulillah, tubimi për të lexuar Kur’anin dhe bërja dua është vepër e pëlqyer dhe e mirë”<sup>3</sup>.

Qëndrimi i dijetarëve të njohur

1. Imam Sehaviju (r.a.) ka thënë:

2. Ahmed bin Abdul Halim bin Tejmijete el-Haranijju Ebul Abbas, “Iktidau-s-Siratil Mustekim Muhalefetu As’habul Xhehim”, boton “Es-Sunnetul Muhammedijjetu”, Ka-hiro. vit. 1369h. botimi i II. faqe 297

3. Ahmed bin Abdul Halim bin Tejm - jete el-Haranijju Ebul Abbas, “Mexhmu’ul Fetava, boton “Darul Kutubuil Ilmijjeti”, Liban-Bejrut, vol. 22 faqe 254

në: “ Edhe po qe se në organizimin e mevludit nuk ka kurrfarë dobie përveç se shejtani do të hidhërohet dhe besimtarët do të gëzohen, kjo do të mjaftonte”<sup>4</sup>.

2. Dijetari i madh El-Kastalanijju thotë: “Myslimanët pas tri gjeneratave vazhdimisht e kanë festuar ditëlindjen e Muhamedit (a.s.) duke dhënë sadaka, duke shprehur gëzim, duke i shtuar veprat e mira, duke lexuar historikun e lindjes së Pejgamberit (a.s.) , dhe për këtë arsye ata kanë pasur begati dhe bereqet”<sup>5</sup>.

3. Dijetari Ebu Shame (r.a.) mësuasi i imam Neveviut (r.a.) thotë: “Më e mira risi që është paraqitur në kohën tonë, është ajo që veprohet çdo vit për ditëlindjen e Pejgamberit (a.s.), duke dhënë sadaka, duke e shfaqur gëzimin për lindjen e Muhamedit (a.s.) dhe respektin ndaj tij dhe duke e falënderuar Zotin e gjithësisë që e ka dërguar Muhamedin (a.s.) si mëshirë për mbarë botët”<sup>6</sup>.

4. Komentatori i Sahihut të Buhariut, dijetari i madh dhe shejhulislami Ibn Haxher el-Askalanijju<sup>7</sup>, është pyetur rreth festimit të ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) dhe ai është përgjigjur kështu: “ Në parim kjo vepër është risi që nuk është zbatuar nga tri gjeneratat e para (sahabet, tabinët dhe tabei tabinët), mirëpo në këtë veprim (festim) ka gjëra të mira, prandaj mund të konkludojmë se është risi e mirë. Këtë e mbështes në atë që përmendet në Buhari dhe Muslim se kur ka arritur në Medine Pejgamberi (a.s.) i ka parë hebrenjtë duke agjëruar ditët e ashures, dhe i ka pyetur se përse agjërojnë ? Ata i kanë thënë: “Kjo është dita kur Allahu e ka për-

4. www. alsaha

5. Sherh el-Kastalenijju ala sahihil buh - ri

6. Shiço: Et-tahdhiru minel igtirari bima xhae fi kitabil hivar, nga prof. Abdul Kerim dhe prof. Abdul Hajel Amravi

7. Fetava-sh-Shejh Reshid Rida vol.IV. faqe 1243

*“Festimin e ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) e konsideroj festë për myslimanët, festë në të cilën ata shprehin gëzimin dhe harenë e tyre për ditëlindjen e Pejgamberit (a.s.).”*

mbysur Faraonin dhe e ka shpëtuar Musain, prandaj ata agjërojnë si falënderim ndaj Allahut. E Pejgamberi (a.s.) u tha: “Ne e meritojmë më shumë të agjërojmë për Musain se sa ju!

5. Dijetari dhe imami Ibn Ijadi (r.a.) thotë: “Festimin e ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) e konsideroj festë për myslimanët, festë në të cilën ata shprehin gëzimin dhe harenë e tyre për ditëlindjen e Pejgamberit (a.s.). Këtë festë e konsideroj të lejuar duke u nisur nga parimi i kijasit (analogjisë) me festat e tjera”.

6. Dijetari i madh imam Sujutiu ka shfaqur mendimin se festimi i ditëlindjes është e lejuar dhe e mbështetet mendimin e tij, në transmetimin e Bejhekiut nga Enesi (r.a.) i cili ka treguar se Pejgamberi (a.s.) pasi është bërë Pejgamber ka prerë kurban

për ditëlindjen e tij. Dihet se gjyshi i Pejgamberit (a.s.) ka prerë kurban ditën e shtatë të lindjes së Pejgamberit (a.s.) dhe se nuk ka nevojë të ripërsëritet një gjë e tillë. Mendohet se ajo që e ka shtyrë Pejgamberin (a.s.) të presë kurban për ditëlindjen e tij ka qenë shprehje falënderimi ndaj Krijuesit të tij, që e dërgoi si mëshirë për gjithë botët dhe respekt për ymetin e tij, i cili nga ana e tij i dërgonte salavate atij. Rekomandohet për ne si myslimanë të shprehim falënderimet tona ndaj Allahut (xh.sh.) për ditëlindjen e Pejgamberit të Tij, duke u tubuar, duke dhënë sadaka e të ngjashme<sup>1</sup>.

7. Dijetari i mirënjohur Hafidh Shemsudin bin Nasirudin ed-Dimeshkiju (r.a.) thotë: “Është vërtetuar me transmetim të vërtetë se Ebu Lehebit i lehtësohet dënimi në xhehenem ditën e hënë vetëm pse ai i fali lirinë robëreshës së tij e cila e kishte përgëzuar për ditëlindjen e Muhammedit (a.s.)” Për këtë arsye ky dijetar thur këtë poezi:

Kur këtij pabesimtari i vjen lehtësimi,

pasi i tilli është i mallkuar dhe i dënuar me xhehenem përgjithmonë sa herë që të vijë dita e hënë

i lehtësohet dënimi për shkak të gëzimit që ka shprehur për Ahmedin

ç’mendohet për robin i cili gjatë tërë jetës së tij

ka qenë i gëzuar për Ahmedin, dhe ka vdekur me iman<sup>2</sup>.

8. Dijetari i mirënjohur dhe ish myftiu i Mekes Ahmed Zejd Dahlani (ka vdekur me 1066 h.) thotë: “Tradita e njerëzve të cilët

1. Imam Sujutijju, *Hasenul Mekasid fi Amelil Meulid*, pa vend dhe vit botimi, faqe 64-65

2. [www.alsaha.com](http://www.alsaha.com)

e festojnë ditëlindjen e Pejgamberit (a.s.) për respekt dhe nderim ndaj tij është një vepër e pranuar nga shumica e dijetarëve myslimanë dhe një vepër që e kanë vepruar shumë dijetarë të këtij ymeti”<sup>3</sup>.

9. Dijetari dhe muxhtehidi i mirënjohur Imam Shevkaniju ka thënë: “Festimi i ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) është vepër që lejohet të zbatohet”<sup>4</sup>.

10. Ibn Batuta, historian i njohur i shekullit VIII hixhri, përmend se: “Pas çdo namazi të xhumasë dhe në ditën e lindjes së Pejgamberit (a.s.) hapeshin dyert e Qabes nga rojet e saj dhe kadiu i Mekës, Nexhmuddin bin el-Imam Muhjiddin Taberiu shtronte gosti për të gjithë njerëzit në Mekë.”<sup>5</sup>

Disa nga librat e shkruara nga dijetarët e hershëm islamë për festimin e ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.).

1. Ibn Nasirudin ed - Dimeshkiju ka shkruar dy libra:

a. el-Mevridu-saviju fi mevlidil hadiji

b. Xhamiu’l-athar fi mevlidi’l-muhtari

2. Irakiju ka shkruar librin: el-Mevridul henijju fi’l-mevlidi senijji.

3. Imam Sehaviju ka shkruar librin: el-Fahru’l-ulevijju fi’l-mevlidi nebevijji.

4. Imam Sujutiu (r.a.) ka shkruar librin: Husnu’l - maksadi fi amelil-mevlidi.

5. Ibn Kethiri (r.a.) ka shkruar

3. Ahmed Zejd Dahlani, *Es-siretu-n-Nebevijetu vel Atharul Muhammedijetu*, faqe 51.

4. Shiço librin e këtij dijetari: *El-Bedru et-Tali’u*

5. Ibn Betuta, *Rihletu Ibn Betutah*, boton “Daru Nefais”, 1997, pa vend botimi, faqe 347.

një libër për ditëlindjen e Pejgamberit (a.s.)

A të shpie çdo risi (bidat) në xhehenem?!!!

Shumë e vërtetë është që Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Çdo risi të shpie në humbje, e çdo humbje në zjarr”. Në këtë rast fjala “كل” (çdo), është shprehje që argumenton kuptimin e përgjithshëm të tekstit (العموم), mirëpo në këtë rast kjo shprehje është në kuptim të përgjithshëm që pranon specifik (عام مخصوص), që me këtë nënkuptohet se çdo risi nuk mund të thuhet se është humbje që të shpie në xhehenem. Po ashtu kuptimin e fjalës “كل” (çdo) e gjejmë në Kur’an në kuptim të përgjithshëm që pranon specifikimin, si f.v. ajeti : “(Era) rrënon çdo send me lejen e Zotit të saj...” (Ahkaf:25). Dihet se era nuk shkatërron çdo gjë, por disa gjëra. Ky lloj i specifikimit të kuptimit të përgjithshëm në shkencën e metodologjisë së fik-

hut njihet si (الخاص المنفصل من المحس). Këtë mendim rreth pjesëzës “كل” (çdo) në këtë hadith ka shprehur edhe Imam Neveviu, komentuesi i Sahihu’l-Muslimit. Ky dijetarë mendon se risitë (bidatet) mund të jenë të refuzuara në sheriatin islam dhe mund të jenë të pranuar.

Transmetohet se Ibn Haxheri (r.a.), komentuesi i Sahihut të Buharit, ka thënë: “ Çdo gjë që nuk është vepruar në kohën e Pejgamberit (a.s.) konsiderohet risi (bidat), mirëpo disa prej tyre janë të refuzuara në shariat, e disa prej tyre janë të pëlqyera dhe të pranuar në shariat”.

Transmeton Ebu Nu’ajmi nga Ibrahim Xhunejdi se ai ka thënë që e ka dëgjuar imam Shafiun (r.a.) duke thënë: “Bidati (risia) është dy llojesh: bidat i lavdëruar dhe bidat i urryer. Ai bidat që pëlqehet me sunetin është i lavdëruar, ndërsa ai bidat që kundërshtohet me sunetin është i papranuar”.

Kur qartë kuptohet se fjala “كل” (çdo) në hadith e ka kuptimin e përgjithshëm të specifikuar që d.m.th. disa bidate e jo çdo bidat, na bëhet obligim të mendojmë në kuptimin e hadithit : “Kush e hap një rrugë të mire në Islam, atij i përket shpërblimi (pse e ka filluar atë punë të mirë), po ashtu i takon edhe shpërblimi i atij që e kryen atë punë, pa iu pa-

kësuar shpërblimi atij që e punon atë vepër...”. Hadithi i tillë argumenton qartë se myslimani ka mundësi të bëjë një punë të mirë edhe se ajo nuk është praktikuar në kohën e Pejgamberit (a.s.). Fjala “من سن سنة...” që në shqip do të thotë “Kush hap një rrugë...” nënkupton që, nëse vepron diçka e mirë, e verifikuar me ixhtihad (studim të hollësishëm) nga dijetarët dhe që nuk bie në kundërshtim me parimet e përgjithshme të rregullave dhe të burimeve të shariatit, atëherë ajo vepër pranohet dhe lejohet të zbatohet.

Ka disa nga masa e përgjithshme e njerëzve që thonë: “Po të ishte festimi i ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) çështje që duhet të kryhet, a nuk do t’ia kishte shpjeguar Pejgamberi ymetit të tij?!” Përgjigja e kësaj pyetjeje është se, zbatimi i një vepre që nuk e ka vepruar Pejgamberi (a.s.) apo shokët e tij nuk është i ndaluar. Pikërisht për këtë arsye imam Shafiun (r.a.) mendon se nuk mund të konsiderohet kategorish e ndaluar çdo vepër që nuk është praktikuar nga Pejgamberi (a.s.) apo shokët e tij. Dijetarët e vlerësojnë të paargumentuar dhe të papranuar pikëpamjen që shprehet se ajo vepër që nuk e ka vepruar Pejgamberi (a.s.) është automatikisht e ndaluar.

Po ashtu disa mundohen ta mbështesin kritikën ndaj festimit të ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) duke u mbështetur në hadithin e Pejgamberit (a.s.): “Mos e teproni duke më lavdëruar mua, sepse mund të bëheni siç të krishterët që e kaluan kufirin ndaj vlerësimit të Isait, birit të Mejremes (a.s.). Vërtetë unë jam rob i Allahut dhe Pejgamber i Tij”. Sipas komentit të Ibn Haxherit (r.a.) me shprehjen “Mos e teproni duke më lavdëruar...” nënkuptohet që mos ta konsiderojmë Pejgamberin (a.s.) siç e konsideruan



të krishterët Isain a.s., bir i Zotit apo edhe Zot. Duhet të jetë e qartë se ditëlindja e Pejgamberit (a.s.) festohet si rast gëzimi për ardhjen e tij në botë si mëshirë për njerëzimin.

Ka shumë çështje, të cilat nuk i kanë vepruar sahabet, tabiinët dhe tabei tabiinët, dhe që sot myslimanët i veprojnë si f.v.:

1. Mbledhja e njerëzve për të falur me xhemat namazin e natës pas faljes së namazit të teravisë në të dy haremet. Një veprim i tillë nuk është vepruar nga tri gjeneratat e para myslimane.

2. Leximi i duasë së përfundimit të Kur'anit në namazin e teravisë dhe në namazin e natës.

3. Veçimi i natës së 27 të ramazanit si natë e përmbylljes së leximit të Kur'anit në namaz të teravisë në dy Haremet e Mekës dhe të Medinës.

4. Thirrja për namaz të natës pas faljes së namazit të teravisë duke thënë Salatu'l-kijami ethabekumullahu.

5. Ndarja e çështjes së tevhidit në tri grupe: Tevhidu'l-uluhije, tevhid'u-rububijeti dhe tevhidu esmai ve sifati. Kjo lloj e ndarjes së tevhidit nuk është bërë me hadith, as sahabët nuk e kanë bërë këtë ndarje dhe as imamët e kësaj mëshirë.

Duhet pasur parasysh edhe fakti se ka shumë vepra të cilat Pejgamberi (a.s.) i ka lënë pa i zbatuar, moskryerjen e të cilave dijetarët myslimanë mendojnë se e kanë bërë për njërin nga këto tri arsye:

1. I ka lënë disa vepra pa i zbatuar, sepse është paraqitur nevoja për t'i zbatuara si f.v. luftimi i atyre që kundërshtojnë dhënien e zekatit, të cilët i ka luftuar Ebu Bekri (r.a.) Pejgamberi (a.s.) nuk i ka luftuar të tillët, sepse në ko-

hën e tij nuk ka pasur ndonjë mysliman që ka kundërshtuar dhënien e zekatit. Duhet ta kemi të qartë se Ebu Bekri (r.a.) ka vepruar diçka që Pejgamberi (a.s.) nuk e ka vepruar, atëherë vallë kjo mos na jep të drejtë të themi se Ebu Bekri (r.a.) ka bërë bidat (risi).

2. Moskryerja e disa veprimeve rreth të cilave ekziston arsyeja e mospraktikimit nga ana e Pejgamberit (a.s.) si f.v. nuk e ka falur namazin e teravisë me xhemat vetëm e vetëm se ka pasur frikësuar se ymeti do ta kuptojë atë namaz si farz. Nga kjo kuptohet se të falurit e namazit të teravisë me xhemat është vepër e rekomanduar, ngase nuk ekziston më frika se ai do të konsiderohet farz.

3. Moskryerja e disa veprimeve nga ana e Pejgamberit (a.s.), për të cilat ka ekzistuar arsye, por për veprimin e të cilave nuk ka asnjë pengesë, si f.v. mos thirrja e ezanit për namazin e bajrameve.

Moskryerja e këtyre veprimeve nga ana e Pejgamberit (a.s.) i hapin rrugën zbatimit të disa akteve që Pejgamberi (a.s.) nuk i ka praktikuar, me kusht që të dihet shkaku i moszbatimit të tyre.

Ka që thonë se nuk duhet të festohet ditëlindja e Pejgamberit (a.s.), sepse në të njëjtën ditë ai edhe ka vdekur, dhe për këtë nuk mund të ketë gëzim atë ditë!?!

Këtij arsyetimi i përgjigjet shumë qartë dijetari i madh Xhelaludin Sujutiu (r.a.) në librin e tij "El-Havi li'l-fetava", faqe 193, ku shkruan: "Padyshim se lindja e Pejgamberit (a.s.) është begatia më e madhe që Allahu na ka



dhuruar, ndërsa vdekja e tij është fatkeqësia më e madhe për ne. Vërtetë sheriatu islam na nxit që të shprehim gëzim për begatinë e Allahut xh.sh. dhe durim dhe qetësi në fatkeqësi. Për këtë sheriatu islam urdhëron që të prehet kurban për foshnjën e lindur me qëllim shprehjen e gëzimit dhe të falënderimit dhe na ka ndaluar të vajtojmë e të dëshpërohemi duke i humbur shpresat në Zotin (xh.sh.) Të gjitha rregullat e sheriatit na tregojnë qartë se shprehja e gëzimit për lindjen e Pejgamberit (a.s.) është e preferuar, ndërsa hidhërimi dhe pikëllimi për vdekjen e tij e ndaluar".

Në fund e përmbylli këtë artikull me mendimin se, po qe se e festojmë ditëlindjen e Pejgamberit (a.s.) për respekt dhe dashuri ndaj tij do të ishte më mirë dhe se duhet të mbështetemi në mendimet e atyre që e lejojnë festimin e ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.). Gjatë festimit të përkujtojmë se Pejgamberi (a.s.) dhe veprat e tij janë shembull dhe model për ne myslimanët. Allahu Alem (Allahu di çdo gjë më mirë).



# Vahshiu

*“Ai e mbyti më të mirin njeri pas Muhamedit,  
më pas e mbyti edhe më të keqin”*

*Historianët*

*Shumë gjak qe derdhur edhe ndër arabë  
Shuhej një fis e tjetri mbetej me plagë  
Dhe u shkrua për këto të liga në histori  
U trazua edhe deti nga shtrat' i tij  
Derisa fe e Allahut nuk nguli këmbë  
Monstrumet e kohës mateshin me pëllëmbë  
Ish' nga Habeshi një Harb El-Habeshij  
Ebu Deseme ishte edhe ofiq i tij  
Lindur e rritur në një vend të thatë  
Po të shtijë me heshtë e kish' zanat  
Dhe këto nuk janë thashë e theme  
Po trimëri e tij ishte me të leme  
Moti ndër arabë ka qenë adet  
Të kenë qole zotërinjtë e vërtetë  
Hiç s' bënte punë trimëri e tij  
Mall e kish diellin ta shohë me sy  
Nisi të rrëfejë Vahshiu për këtë zotëri  
Kurrë s'e pashë të qeshë surrat i tij  
Në luftën e Bedrit vetë më tha ai  
Hamzai i pati vrarë ungjin e tij  
Dhe nisi të përbehet në Uza dhe Lat  
Kurrë s' do ta lë pa i marrë hak  
Për nijete të këqija kurrë s'bëhet vonë  
Kështu thanë të moçmit, kështu edhe tash thonë  
Shpejt po afrohej luftë e Uhudit me gjak  
Duhet vrarë Muhamedi, të marrim hak  
Për t'i dhënë flakë luftës, sa më shumë gra  
Këtë hile me shumë sherr Ebu Sufjani e tha  
Egërsinë e tyre s'e kanë me karar  
Do të tërbohen fare kur të shohin të vrarë  
Shumë afër m' u afrua zotëria që isha rob i tij  
M' u gërmua ashpër dhe vetullat i ranë mbi sy  
Po deshe prangat t' i heqësh përgjithmonë  
Do ta bësh një nam që mua më gëzon  
Ta vrasësh Hamzain që është më trim  
Ti do të jesh i lire, po edhe shpirti im*

*Më doli para edhe Hindi më tha, o Vahshi  
Na i shëro këto plagë e kot mos rri  
Mësymë Uhudin dhe lufta mori zjarr  
Nuk e shihje tjetrin, veç Hamzait në ballë  
Bile në krye e vinte edhe një nishan*

*Ta shohin kurejshitet kush është trim me nam  
Hiç s'po trembej Hamzai doli në dyluftim  
Para këmbëve të tija u rrëzua edhe një trim  
Unë e zura në thumb mire dhe hodha një shigjetë  
Fort mirë e godita dhe ai u rrëzua vetë  
Nuk ia hoqa heshtën, ish futur në trup në thellësi  
Po kush nuk trembej edhe nga hije e tij  
Dhe tash Hindi mbi të u vërsul me vrap  
T'i nxjerrë zemër e mushkëri  
Trimit të larë krejt në gjak  
Unë e mbyta Hamzain dhe zotëria mbajti fjalë  
Isha një robër, tash lirshëm po dalë  
Po në këtë fe të Zotit tash do futen më shumë  
Dhe me mua dikush do të ketë punë  
Ika atje në Taif të gjej pak rehati  
Edhe aty shehadeti ish' futur në çdo shtëpi  
Nisi të më shembej edhe zalli ndër këmbë  
Të shkoj atje në Jemen o në t' largëtin Sham  
Kisha bërë një punë të keqe, rashë pishman shumë  
Një fjalë të peshuar, që më tha njëri, më zптоi shumë  
Shko më tha te Muhamedi se ai njeri s' vret  
Ai që braktis qyfrin dhe hyn në fenë e Vërtetë  
Unë me të shpejtë ika në Medine, Pejgamberi ishte në xhami  
Hiç nuk më pa', iu afrova shumë atij  
Aty me një frymë e thashë shehadetin  
Qe e befasishme, edhe për Profetin  
Më pas më shikoi dhe më tha: a je ti, o Vahshi?  
Po i thashë, o Resulullah; ai uli shikimin e tij  
Eja ulu këtu dhe më kallëzo si e mbyte Hamzanë  
Këto fjalë të Pejgamberit shpirtin keq ma vranë  
Dhe rrëfeva për këtë ngjarje siç ish' e vërtetë  
Mjerë për ty, o Vahshi, më tha Resullullahi vetë  
Tani në zemrën time hyri një brengë thellë  
Po secili do të korrë atë që ka mbjellë  
Ndërroi jetë Pejgamberi shkoi në Ahiret  
Në vendin e tij erdh halifi më i drejtë  
Një fis e kish pranuar islamin, tash u bënë renegatë  
Lanë fenë e Zotit iu kthyen idhullit Lat  
Më në zë ndër ta Musejleme me plot sherr  
Pas Muhamedit tha unë jam pejgamber  
Tash po i thoja vetvetes çfarë pret, o Vahshi  
Të vrasësh këtë tradhtar, o të bëhesh shehid ti  
Nisi luftë e tmerrshme me këta të përdalë  
Musejleme gënjeshtari u rrinte në ballë  
Me vete e mora heshtën që vrava Hamzanë  
Mësyva kah ai, e të tjerët s'më panë.  
Tash e vura në nishan, ta godas më mirë  
E kjo punë për mua hiç s'ish e vështirë  
E mbyta unë këtë të mjerë apo një ensari  
Veç Allahut Një, këtë kush mund ta dijë  
Dhe kështu sosi rrëfimin Vahshij el-Habeshij  
Njëherë si mushrik, po tash si sahabij.*

## SÂLLNÂMET - VJETARET

**N**jë ndër burimet e rëndësishme që ia rrisin vlerën pasurisë së shtetit Osman janë edhe vjetarët (sallname). Dihet se shteti osman kishte një administratë të madhe dhe të mirëorganizuar, gjë që i siguroi perandorisë një jetëgjatësi 500 vjeçare. Fjala *sallname* është fjalë persiane e formuar nga dy fjalë që janë *sal* që do të thotë *vit* dhe *name* që do të thotë *libër*, *shkresë*<sup>1</sup> etj. Kuptimi terminologjik i *sâlnâmes* është vjetar, regjistër i tubuar për ngjarjet, ndodhitë, statistikat, gjendjen ekonomike, prodhimet dhe ngjarjet e shënuara të një shteti (në këtë rast shteti Osman) brenda një viti të caktuar.<sup>2</sup> Nga kjo nuk kuptojmë vetëm rreth pasurisë dhe arkës shtetërore të qendrës së Stambollit, por edhe regjistrimin e gjithë veprimtarive të ndarjeve të mëdha dhe të vogla administrative që ishin brenda kufijve të perandorisë. *Sâlnâmet* kanë të bëjnë në masë të madhe edhe me statistikat e trojeve shqiptare, në mënyrë të detajuar Sallnametë e vilajeteve. Nga viti 1879 deri në vitin 1900 janë botuar vjetarë të veçantë që përfshinin trojet e mirëfillta etnike shqiptare si; Sallnamet e vilajeteve të Kosovës, Shkodrës, Shkupit, Janinës, Manastirit etj. Vjetarët nuk duhet të ngatërrohen me kalendarët

zyrtar (takvim).<sup>3</sup>

Duke u bazuar në burimet që kemi mundur t'i hasim nëpër disa arkiva dhe në disa libra të tjerë që gjenden nëpër biblioteka të ndryshme qoftë shtetërore apo private, do të sjellim shkurtimisht njohuri rreth *sâlnâmeve* të vilajetit të Kosovës dhe rrethinës së saj. Por gjithmonë duke e pasur parasysh se në të ardhmen mund të dalin në pah edhe dokumente apo *sâlnâme* të tjera që nuk janë regjistruar nga ana e drejtorisë së arkivave deri më sot. Vlen për t'u nënvizuar se këto dokumente të vjetra në lidhje me trevat tona mund të hasen edhe në pjesën e Anadollit, gjegjësisht në Arkivin Kombëtarë të Dorëshkrimeve dhe atij Yusuf Ağa Kütüphanesi në ish kryeqytetin e Selxhukëve në Konja si dhe në Arkivin Shtetërorë në Antalja.

Për herë të parë në Shtetin Osman kërkesën për hartimin e *sâlnâmeve* e ka parashtruar Koxha Reshid Pasha me ndihmën e Ahmed Vekif Efendiut dhe Ahmed Xhevdet Pashës. Mes viteve 1847 deri në vitin 1334 H janë botuar 68 *sâlnâme*, Vjetarët e Portës së Lartë Osmane apo *Sâlnâmet* e Shtetit Osman. Më pas kjo detyrë iu transferua Sekretariatit të Ministrisë së Arsimit dhe Akteve Perandorake. Me kalimin e kohës, kjo ka kaluar nëpër organe të ndryshme të shtetit. *Sâlnâmet* e botuara mund të klasifikohen në pesë grupe kryesore, që ndahen në nëngrupe tjera:

1. \* Selçuk Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü, Yüksek L - sans ögr. Konya

Ferit Devellioğlu, Osmanlıca Türkçe Ansiklopedik Lugat, f. 1100, Ankara, 1970.

2. D. Mehmet Doğan, Büyük Türkçe Sözlük, f. 1137, boton Vadi Yayınları, botimi 15, Ankara, 2001; Türk Dil Kurumu (T.D.K.), Türkçe Sözlük, f. 1692, botimi 10, Ankara, 2005.

3. M. E. B. İslam Ansiklopedisi, vëll. 10, f. 134, İstanbul, 1966.

### A. Vjetarët Shtetërore:

Siç përmendem edhe më lartë, për herë të parë është shkruar me iniciativën e Koxha Reshid Pashës. Këtu bëjnë pjesë vetëm dokumentet zyrtare shtetërore.

### B. Vjetarët e Vilajeteve:

Termi vilâjet me kalimin e kohës është përdorur edhe si ejâlet dhe sanxhak, që këtu mund të themi se në këtë grup hyjnë Sallnamet e komunave, krahinave, provincave dhe regjioneve të ndryshme. Për herë të parë thuhet se nga ky lloj vjetari është shkruar në Trabzon në vitin 1866. Mirëpo sipas Sami Frashërit<sup>1</sup>, Sallnameja e parë e vilajeteve është ajo e Halebit e shkruar në vitin 1284-1328. Edhe këto Sallname janë zyrtare por në një nivel më tjetër se ato të parat. Këtu do t'i përmendim vetëm Sallnamet e Ballkanit: Sallnameja e Vilajetit të Bosnjës 1283-1308 (15 numra), Bosnja Hersek 1301 (5 nr.), Sallnameja e Shkodrës – 1299-1315 (5 nr.), e Kosovës – 1296-1318 (8 nr.), Manastir – 1292 – 1314 (9 nr.), Prizren – 1290 (1 nr.), Selanik, 1287-1325 (23 nr.), Shkup – 1311 (1 nr.).

### C. Sallnametë e Institucioneve dhe të Organizatave Zyrtare:

Këtu bëjnë pjesë Sallnametë e punuar nga disa burra shteti që me vullnetin e tyre kanë filluar një punë të tillë, për t'i tubuar vepërimitarët e tyre, që ishin të varura për ta etj. *Sâllnâme-i Askeri* (në mes viteve 1282-1326 janë shtypur 17 Sallname), *Harbiye Nezâreti ve Makam Seraskeri*, *Rasad'hane-i âmire Sâllnâmesi* (më 1288 është botuar vetëm një), *Sâllname-i Bahrî* (1307 – 1330, 17 numra), *Maârif Nezâreti Sâllnâmesi* (në mes viteve 1316-1321 janë shty-

pur 5 apo 6 Sallname), *Rûsûmât Sâllnâmesi* (1332, një numër), *Îlmiyye Sâllnâmesi* (1334, një Sallname)<sup>2</sup>

### D. Sallnametë me tematika të veçanta apo organizatave të individeve:

Nga vetë emri kuptohet se janë të llojit privat, e që këto i kanë shkruar organizatat private apo edhe ndonjë myfti etj. Mund të përmendim atë të Ali Suvariut, Ebuzziya Tevfik Beut etj.<sup>3</sup>

Në vitet 1280 / 1863, Ali dhe Fuad Pasha morën një iniciativë për sistematizimin e ejaleteve. Emri i ejaleteve u shndërrua në vilajete. Në Anadoll dhe Rumeli u formuan qendra të veçanta për këto çështje. Qëllimi ishte që edhe në vendet tjera të bënin një sistematizim të tillë.<sup>4</sup> Më 1867 u shkrua edhe një dokument lidhur me këto ndryshime "*Idare-i Vilâyet Nizâmnâmesi*" dhe sipas kësaj u caktua kufiri dhe sipërfaqja e çdo vendi. Siç duket kjo ka ndikuar në të mirë të vendeve dhe popullit sepse, sipas kësaj ndarjeje, iu lehtësua orientimi popullatës.

Një ndarje tjetër e këtyre vilajeteve është bërë edhe ka fundi i sulltanatit të Sulltan Abdylhamidit II-të në vitin 1908.

## SALLNAMET E VILAJETIT TE KOSOVES

### سالنامهء ولايت قوصوه

Vilajeti i Kosovës u formua në vitin 1877. Valiu i parë i sajë ishte Halil Rifat Pasha. Siç e cekëm edhe më lartë, në periudhën e fundit të Dinastisë Osmane vilajetet-prefekturat

2. M. E. B., po aty, f. 135.

3. Hasan Duman, Osmanlı Sâllnâmeleri ve Nevasilleri, vëll. I, f. 3-17, Ankara, 1999.

4. Duman, I, 169.

1. Şemseddin Sami, Kâmûsu'l A'lâm, III, 1916.

janë emëruar apo përdorur si ejaletë – administrata lokale apo krahina dhe si udhëheqës i sajë ishte valiu. Sanxhakët që ishin të lidhura me vilajetet, udhëhiqeshin nga kajmekami – nënprefekti që në kohën tonë quhet edhe prefekturë apo edhe komunë. Si udhëheqës më të mëdhenj për regjionet që ishin të lidhura me sanxhaqet ishin mutesarrafet, kurse për komunat dhe trevat tjera ishin drejtorët e po këtyre trevave.

Kufijtë e Vilajetit të Kosovës; në lindje Bullgaria, në perëndim Shkodra së bashku me Malin e Zi dhe Bosnjën, në jug vilajeti i Manastirit dhe Selanikut dhe në veri si fqinjë e ka Serbinë. Ky Vilajet ishte një vilajet shumë i madh me pozitë gjeografike që shtrihej nga Rumelia – jugu i Shtipit të Maqedonisë së sotme dhe që zgjat gjerë në veri jug të saj dhe nga sanxhaku i Tashlëxhes (Plevjes) që është në kufi me Bosnjën. Ky Vilajet ishte një vend i madh që dominonin etnitete të shumta si; Turqit, Shqiptarët dhe Boshnjakët e Ballkanit – të gjithë këta muslimanë-, pastaj Bullgarët, Maqedonët<sup>1</sup>, Serbët, Romët, Vllahët- të gjithë këta të krishterë. Ishte fqinjë edhe me Serbinë, Malin e Zi që nga pushtimi i Austrisë – Hungarisë më 1878 edhe me Bosnja Hercegovinën.

Si kryeqendër e këtij vilajetit në mes viteve 1879-1893 ishte Prishtina, kurse nga viti 1893 ishte bërë qyteti i Shkupit. Në vitin 1893 ajo kishte një popullsi me 847.419 banorë. Nga këta 507.080 Muslimanë, 340.339 të Krishterë. Salnamja e Vilajetit të Kosovës gjithsejtë tetë herë është botuar. Së pari;

- Në vitin 1879 (1296 hixhri) në Prishtinë

1. Perandoria Osmane në regjistrimin dhe numërimin e popullatës këta i ka emëruar si Bullgar Makedon.

në Shtypshkronjën e Vilajetit të Kosovës<sup>2</sup>, plotë 154 faqe shtyp guri. Kurse të tjerat me radhë

- Në vitin 1883 (1300 hixhri) në Prishtinë, Shtypshkronja e Vilajetit të Kosovës me plotë 178 faqe.

- Në vitin 1885 (1302 hixhri) në Prishtinë, Shtypshkronja e Vilajetit të Kosovës me plotë 176 faqe.

- Në vitin 1887 (1304 hixhri) në Prishtinë, Shtypshkronja e Vilajetit të Kosovës me plotë 314 faqe.

- Në vitin 1888 (1305 hixhri) në Prishtinë, Shtypshkronja e Vilajetit të Kosovës me plotë 283 faqe.

- Në vitin 1893 (1311 hixhri) në Shkup, Shtypshkronja e Vilajetit të Kosovës me plotë 239 faqe.

- Në vitin 1896 (1314 hixhri) në qytetin e Shkupit, Shtypshkronja e Vilajetit të Kosovës me plotë 753 faqe.

- Sallnameja e fundit e Vilajetit të Kosovës është shtypur në Shkup më 1900 (1318 hixhri) në Shtypshkronjën e Vilajetit të Kosovës me plotë 936 faqe.<sup>3</sup>

I gjithë koleksioni i Sallnameve të Vilajetit të Kosovës për fat të keq përveç nuk mund të themi që gjendet neper të gjitha arkivat apo bibliotekat kombëtare në Turqi. Besojmë se është shumë e dobishme të ofrojmë një listë të bibliotekave që mund të gjenden këto vepra të çmuara.

## **NJOHURI RRETH SALLNAMES SË**

2. Origjinali: Kosova Vilayeti Matbaasi.

3. Hasan Duman, Osmanlı Sâlnâmeleri ve Nevasilleri, Ankara, 1999.

## VILAJETIT TË KOSOVËS - VITI 1314 (1896)<sup>1</sup>

Ndër Sallnamet e Vilajetit të Kosovës që ne i posedojmë dhe nga hulumtimet e bëra, më me përmbajtje të gjerë mundë të themi se është ajo e vitit 1896 (1314) pasi që është nga më të vonshmet dhe për këtë ndarjen e qyteteve, fshatrave dhe vendeve tjera e ofron më në hollësi.

Në këtë Sallname në radhë të parë marrin vend takvimi dhe kohet e namazeve të vitit, më pas janë dhënë njohuri të hollësishme për mënyrat dhe format e të shkruarit nga shtresa e ulët dhe e lartë diplomatike, data e lindjes dhe vdekjes së padishahëve, viti i ardhjes së tyre në pozitë dhe vendet se ku janë të varrosur. Pas këtyre janë ofruar informata rreth medaljeve dhe shpërblimeve që u është ndarë ushtarëve dhe parisë me pozita më të larta.

Pasi që janë shënuar qendrat dhe organizatat ushtarake të Vilajetit, janë dhënë edhe emrat, pozitat, detyrat e të gjithë punëtorëve të shtetit dhe sanxhaqeve që ishin të lidhura për këtë vilajet. Këto gjashtë sanxhaqet dhe rrethinat e tyre janë:

1- Sanxhaku i Qendrës së Shkupit me regjionet; Shtip, Bereketli, Kumanovë, Radovishte (Radofcë), Palanka, Koçana dhe Orhanije.

2- Sanxhaku i Prishtinës me regjionet; Mitrovicë, Vuçitërnë, Gjilan, Preshevë.

3- Sanxhaku i Novi Pazarit me regjionet; Akova, Novi Varosh, Kollshin.

4- Sanxhaku i Prizrenit me regjionet; Tetovë, Luma, dhe krahinat; Gostivar, Radofcë dhe Kalis.

5- Sanxhaku i Pejës me regjionet; Gjakovë, Brane, Tergovisht dhe Gosine.

6- Sanxhaku i Plevjes me regjionet; Prepol dhe Priboj.

Në Sallname mund të hasim data dhe vite të ndryshme që ndoshta nuk mundë që t'i hasim edhe nëpër enciklopeditë dhe fjalorët enciklopedik.

Kjo Sallname, është shkruar në vitin 1896 (1314 hixhri) në Shkup, e shtypur për të shtatën herë në shtypshkronjën e po këtij vilajeti. Edhe pse është shkruar e shtypur në Shkup, titullohet "سالنامهء ولايت قوصوه" - **Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova**". Flet rreth vilajetit të Shkupit, sanxhakut të Prishtinës, Novi Pazarit, Prizrenit, Pejës, Plevljes, rreth Shqiptarëve, Shqipërisë dhe historisë së saj, të gjitha këto me rrethinat e tyre, duke filluar nga fshatrat, komunat e gjerë tek qytetet. Për çdo fshat apo qytet janë dhënë informacione të hollësishme, si p.sh. numrit të popullatës së atij vendi, numrin e meshkujve dhe femrave, myslimanëve dhe të krishterëve, medreseve, xhamive, kishave, urave, qendrës së komisariatit policorë, tubimit të pasurisë vjetore, drithërave, kohen e korrjes së tyre, hyrjes dhe daljes së mallrave nga jashtë. Pastaj rreth historisë dhe pozitës gjeografike të këtyre vendeve, ndarjen administrative, ekonominë, kulturën, rreth personaliteteve të ndryshme etj. Thënë shkurt, gjithçka që ka ndodhur është regjistruar me një përpikëri të madhe.

1. Kjo salname, është transkriptuar në alfabetin latin nga org - nizata dhe shtëpia botuese "Rumeli Türkleri Kültür ve Dayanışma Derneği Yayınları" në Stamboll, 2000.

## FRYMËRA MËSHIRONJËSE DHE MREKULLIA KURANORE

**K**ëto ditë shtëpia botuese Progresi, realizoi botimin e veprës “Frymëra mëshironjëse nga Profeti i mëshirës dhe mrekullia kuranore” të autorit Osman Nuri Topbash.

Autori Osman Nuri Topbash shprehet se shkaku themelor i përpjekjes së tij për ta shprehur jetën shembullore e të zgjedhur të të Dërguarit të Allahut qoftë edhe brenda kufijve të ngushtë të rreshtave, ka qenë gjetja e mundësisë për t’u ofruar një rreze drite nga fryma shpirtërore e tij zemrave të turbulluara, të lodhura e të drobitura në ditët tona, kur njerëzimi i nënshtruar përgjithësisht ndaj materies dhe forcës, po jeton nën sundimin e egos, dëshirave dhe pasioneve të ulëta! Veç kësaj, ka qenë dëshira e zjarrtë e këtij autori të njohur tashmë nga lexuesi i trojeve shqiptare, për të mund të marrë

pjesë nga virtytshmëria dhe përkryershmëria e Profetit tonë të dashur, të cilin e kanë përshëndetur edhe drurët dhe gurët, të cilin e kanë lartësuar Krijuesi i Lartë i Gjithësisë së bashku me engjëjt e Tij të panumërt, duke e përshëndetur me salat dhe selam, pra, duke u lutur për paqe e mëshirë për të!

Njëra prej enigmave të evenimentit dashuri që është shkaku i ekzistencës së gjithësisë, është hyrja e dashuruesit në rrugën e tjetërsimit thelbësor me anë të shndërrimeve në tipare sipas tipareve të të dashuruarit. Pavarësisht se në ç’masë janë mundësia dhe kapaciteti i dashuruesit, është e padiskutueshme se dashuria jep një rezultat në çfarëdo niveli sasior e cilësor sipas vlerave sublime të subjektit ose objektit për kah i cili priret!



Tërë njerëzimi është nevojtar për ndërmjetësimin e Profeti. Edhe mundësia për ta konceptuar në mënyrë të përkryer të vërtetën e Tij me anë të aftësisë njohëse njerëzore, edhe mundësia për ta shpjeguar me anë të fjalëve këtë konceptim të arritur, është e pamundur. Në të vërtetë, deklarimi mbi entitetin e Tij të lartë nuk ka mundësi tjetër veç mbylljes në pafundësinë e hesh-tjes! Ndërkaq që në përshkrimin e jetës së Tij të shquar, gjuhët paraqiten absolutisht të dobëta e të paaftha, edhe shprehja e reflektuar nga zemra, në gjuhën e njeriut, është vetëm e vetëm sa një pikë uji në krahasim me detin!

Pavarësisht nga gjithçka, çdo gjë që flet për Të dhe që na e kujton Atë, ka një realitet më vete, një frymë shpirtërore më vete, një poetikë më vete dhe një hijeshi më vete! Një mijë e një ornamente dhe rrjedha të fuqisë hyjnore në gjithësi janë një asociacion, një jehonë dhe një buzëqeshje prej dritës dhe bukurisë sublime të Tij!

Në këtë vepër që, me favorin e Zotit, ka pasur fatin e lumtur të arrijë disa botime në gjuhë të ndryshme të perëndimit dhe të lindjes, madje këto vite të fundit edhe një përkthim në gjuhën kineze, autori Osman Nuri Topbash është përpjekur të paraqesë sipas mundësive të tija të njohjes, përbalimit dhe kapacitetit, edhe një kapitull nga mrekullitë kuranore të cilat, duke vazhduar gjer në kiamet, do t'i ndriçojnë zemrat, nga mrekullitë e Kur'anit që ka qenë dhe mbetet pishtari orientues i rrugës së drejtë të Profetit tonë, Krenarisë së Gjithësisë (a. s.).

Kur'ani i Shenjtë i cili, me urtësitë dhe të vërtetat e Tij të pafundme, i ndriçon zemrat besimtare dhe e thellon meditimin, është një mrekulli hyjnore, ndaj së cilës janë dhe do të jenë nevojtare për mbështetje dhe vërtetim edhe të gjitha zbulimet shkencore që do të bëhen gjer në kiamet. Nisur nga kjo, në këtë ribotim të veprës që mban autorësinë e Osman Nuri Topbashit, nën dritën edhe të zbulimeve të reja të bëra në shekullin tonë, janë bërë edhe disa shtesa mbi shumë urtësi për të cilat aludohet ose theksohet në ajetet

e Kur'anit.

Veç kësaj, në këtë ribotim, me anë të një sërë korrekturash, thjeshtimesh, shtesash të reja dhe shpjegimesh, autori ka bërë disa parashtime e çvendosje brenda temave dhe çështjeve.

Duket sikur pothuaj s'ka mbetur asgjë nga mrekullitë si dhe parimet e sjella prej profetëve të kaluar dhe të përcjella gjer në ditët tona. Kurse mrekullia kuranore do të mbetet gjer në kiamet si një favor i posaçëm për bashkësinë e lumtur të Profetit Muhamed (s.a.s.).

Kjo dhunti hyjnore na kujton neve rëndësinë e njohjes dhe adhurimit të Allahut si Zoti i vetëm i gjithësisë, si dhe lartësinë sublime të dhuntive, në përgjithësi, për të cilat jemi konsideruar të merituar!

Çdo farë jep produkt pavarësisht nga embrioni i saj si dhe në vartësi të kapacitetit të tokës ku mbin dhe bleron. Edhe në zemrën e lexuesit, po qe se "Frymëra mëshire" kaq ka mundur të hedhë shtat në njohjen dhe shprehjen e të vërtetave profetike dhe ka mbetur shtatshkurtër, autori i përgjërohet lexuesit që të metën t'ia dedikojë vetes. Ç'lumturi për ata besimtarë që ia japin zemrën Allahut dhe të të Dërguarit dhe ushqejnë dashuri për ta, si dhe që munden ta mbajnë këtë dashuri mbi të gjitha dashuritë!

Zoti i Lartë pastë mirësinë për të na e mundësuar një pjesë sublime zemrave nga klima ideore e Hz. Muhamedit (s.a.s.) i cili është udhëzuesi i vetëm i udhës së drejtë, për të na spërkatur zemrat me pika vese frymëzimi e begatie nga fryma shpirtërore e gjerë e tij! Zemrat na u bëfshin mjedis i përjetshëm për dashurinë ndaj Allahut dhe Profetit! Zoti na bëftë të gjithëve të merituarit e shefaatit (ndërmjetësimit në ditën e kiametit) të madh të Profetit!

Lexim të këndshëm dhe të frytshëm!



# Shëndeti dhe familja

## TERAPIA GJENETIKE MUND TË RIPËRTËRIJË ZEMRËN?

Shkencëtarët francez morrën qelizat e rëndomta nga muskuli i këmbës së një pacienti dhe i injektuan në zemrën e tij. Qelizat, si duket, zëvendësuan qelizat e muskulit të zemrës. Shkencëtarët tjerë zbuluan se qelizat amë, nga të cilat mund të zhvillohen lloje të ndryshme të qelizave trupore mund të përdoren për kultivimin e enëve të reja të gjakut ose bile të zëvendësojnë indin e sëmurë të zemrës.

Disa grupe të shkencëtarëve kanë arritur sukses që nëpërmes gjeneve dhe proteinave të nxisin zhvillimin e indit të ri të zemrës dhe arterieve.

Teknika e re do të mundësojë zëvendësimin e indit të sëmurë të zemrës - ka thënë dr. Rose Marie Robertson, kryetare e shoqatës së kardiologëve amerikan, në konferencën vjetore të shoqatës.

Nëse këto metoda tregojnë sukses afatgjatë, do t'i ndihmojnë personave me anomalitë në zemër, gjegjësisht me dëmtimin i cili pamundëson punën normale të zemrës - ka thënë dr. Robertson.

Përafërsisht gjysma e këtyre pacientëve vdes gjatë pesë viteve. Qelizat e zemrës nuk mund të zëvendësohen kur vdesin - ka thënë dr. Robertson.

Dr. Philippe Menasche nga spitali "Bicchat" në Paris dhe kolegët e tij kanë hulumtuar se si mund të përmisohet kjo. Kanë bërë eksperimentin tek pacienti 72 vjeçar me dëmtim të rëndë të zemrës pas infarkt të zemrës. Ja morrën një pjesë të indit muskulor nga kofsha, dy javë kemi kultivuar qelizat në kulturë përderisa nuk kemi pasur numër të mjaftueshëm të qelizave muskulore, e pastaj i kemi mbjellur në zemrën

e dëmtuar - tha Menasche.


Pas pesë muajsh qelizat muskulore janë integruar në zemrën e pacientit në pjesëmarrjen në kontraksionet edhe pse jo të njëjta si qelizat e muskulit të zemrës.

Ky është rezultat i shkëlqyer, por duhet me qenë të kujdesshëm - ka thënë Menasche.

Dr. Ray Chin, kryetar i raportit të kirurgjisë kardiotorakale në qendrën mjekësore të universitetit "McGill" ka provuar një qasje tjetër nëpërmes qelizave amë. Këto qeliza mund të zhvillohen në cilin do lloj të qelizave trupore. Ai dhe bashkëpunëtorët e tij kanë hulumtuar 22 minjë, i kanë grirë pjesët e zemrave të tyre dhe u kanë injektuar qelizat amë të palcës eshtërore - burim i njohur i këtyre qelizave të adaptuara për t'i zëvendësuar. Qelizat e injektuara për t'i dalluar i kanë shënuar me kemikate fluorescente. Gjatë periudhës prej katër deri pesë javësh, qelizat e shënuara u kthyen në qeliza muskulore - ka thënë Chin. Ky veprim do të mundësojë përdorimin e palcës eshtërore të vet pacientit, që d.m.th. që nuk do të përdoren ilaçet për parandalimin e hudhjes së indeve.

Grupi i dytë i shkencëtarëve në krye me dr. Joffa Isner nga Universiteti "Tufts" në Boston, ka zbuluar mënyrën tjetër të përdorimit të qelizave. Ata kanë marrë qelizat progjenitore të endotelit që qarkullojnë në gjak dhe zhvillohen në qeliza endoteliale të rritura. Kur është e nevojshme, këto qeliza mund të vijnë deri te vendi ku mund të zhvillohen më tutje - ka thënë dr. Isner.

Kur janë injektuar minjëve me imunitet të dëmtuar te të cilët është simuluar infar-



kthi në zemër, qelizat progjenitore u ngjitën për indin e dëmtuar të zemrës dhe si duket filluan të krijojnë indin i ri. Dr. Isner siç ka thënë do të kërkojë nga administrata amerikane për ushqim dhe ilaçe lejen për humtimin e veprimit të njerëzit.

Përveç kësaj, ai dhe kolegët e tij përpiqen të provojnë terapinë gjenetike nëpërmes së cilës të sëmurit e rëndë të zemrës mundohen të nxisin zhvillimin e qelizave individuale. Një studim sugjeron që pacientët që kanë marrë placebo, u shëruan një lloj i mirë sikur ata që kanë marrë gjene të reja që nxisin zhvillimin e enëve të gjakut. Dr. Timothy Henri nga universiteti "Minnesota" në Minneapolis dhe kolegët e tij kanë

përcjellur 102 pacientë një vit dhe zbuluan që ky "efekt placebo" u zhduk pas një viti.

Vetëm pacientët që morrën gjene të vërteta edhe më tej kanë thënë se kanë ndier dobësimin e dhembjeve dhe simptomave tjera.

Disa janë frikësuar që nxitja e zhvillimit të enëve të gjakut mund të shkaktojë kancer, por dr. Henry nuk ka gjetur argumente për këtë. Katër pacientë, gjegjësisht 10% nga grupi që kanë marrë placebo, janë sëmurar nga kanceri pas një viti - ka thënë dr. Henry. Asnjë pacient i cili ka marrë terapinë gjenetike nuk është sëmurar nga kanceri, ka thënë ai.

## EUROPEANA: BIBLIOTEKA DIXHITALE EVROPIANE

Çfarë është Europeana? Europeana është një projekt që ka filluar në 2007, është një bibliotekë gjigande, muze dhe arkiv virtual shumëgjuhësh e cila fillimisht do të jetë në gjuhët franceze, angleze dhe gjermane. Ashtu si Google Library, projekti i kolosit amerikan, i destinuar për të sjellë falas në web trashëgiminë e bibliotekave amerikane on-line, edhe Europeana nuk është më e pakët. Europeana është një projekt madhështor e cila përfshin të gjithë trashëgiminë kulturore të bibliotekave të 27 shteteve anëtare të Bashkimit, në një përmbledhje prestigjioze të ndërtuar me bit, një trashëgimi prej disa milion veprash në formatin elektronik, ndër të cilat kryeveprat e pavdekshme të letërsisë botërore, por edhe vepra multimediale dhe audio-vizive, si p.sh. fotografi, vepra arti, regjistrime të operave klasike, filmime, si dhe riprodhime të dokumenteve themelore me rëndësi historike.

Për këtë projekt janë dashur disa vite punë dhe një komision i posaçëm, si dhe një investim prej më shumë se 2,5 milion euro në vit.

Ky është vetëm hapi i parë, nëse vërejmë se Komisioni Evropian që ka ndjekur projektin Europeana ka deklaruar që brenda vitit 2010, biblioteka evropiane do të bëjë të mundur vënien në dispozicion të publikut online gati 10 milion vepra të dixhitalizuara dhe me mundësitë që lejon Interneti, të bëjë të mundur bashkëveprimin edhe të përdoruesve për të rritur komunitetin e të pasionuarve dhe personave të cilët do të konsultohen me bibliotekën. Europeana nuk do të lërë jashtë vëmendjes ekstreme problemin e shfrytëzimit të të drejtave të autorit të veprave, ashtu siç ka vepruar dhe Google Library, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pikërisht për të mos rënë në këtë problem jo të vogël dhe për të respektuar të drejtat e autorit dhe punës intelektuale, Këshilli i Evropës po studion një ligj i cili do ta shtyjë kohën e të drejtave të autorit nga 70 në 100 vjet pas vdekjes së autorit.

Europeana funksionon si një portal multimedial dhe veprat që mund të arrihen nëpërmjet saj nuk do të jenë në një kompjuter qendror, por do të mbeten në sitin e institucionit qendror kulturor që funksionon si network. Fillimisht Europeana, në harkun kohor 2009 – 2011 do të jetë e financuar kryesisht gati 80% në shumën prej 2 milion eurosh në vit, nga BE. Shtetet e tjera anëtare të BE dhe institucionet e tjera kulturore do të paguajnë pjesën tjetër.



Funded by the Community programme eContentplus

**EUROPEANA**  
connecting cultural heritage

HOME | About | Provide content | eNews | Press releases | Partners | EDL Foundation | Links | Contact us

Welcome to Europe's digital library, museum and archive

Europeana will launch in **November 2008**, bringing you digitised books, films, paintings, newspapers, sounds and archives from **Europe's greatest collections**

[explore demo version](#)

**The Boots video**  
a quick intro to Europeana

[click here to play the video](#)

**To provide content**  
Organisations that want to provide content to Europeana can go to our [content providers' page](#)

**News and events**

- **Preview of Europeana.eu prototype1** at the conference **Users expect the interoperable**  
23/24 June 2008, Koninklijke Bibliotheek, The Hague  
**Booking now open**
- **Associateship for Ministries**

## SULMI MBI GAZA: MESAZHI I SHTETIT HEBRE NDAJ BOTËS DHE AMERIKËS NË VEÇANTI

**M**ë 27 dhjetor 2008, ushtria izraelite nisi një ofensivë të madhe kundër rripit të Gazës me pretekst eliminimin e bazës logjistike dhe forcave të armatosura të Hamasit.

Nëse përballë kemi konfliktin e përgjakshëm në Gaza, të gjithë pyesin: “Po ku shkoi e drejta ndërkombëtare në Gaza”? Gjithë traktatet e rëndësishme ndërkombëtare

të nënshkruara nga viti 1868 deri në 2008-ën në Gjenevë, në Hagë apo Nju Jork, nuk arrijnë më të ndalojnë dhunën, sepse luftërat e sotme janë krejtësisht ndryshe nga ato që bëheshin dikur. Sot armiku nuk janë grupet guerile apo ushtritë e një shteti, por forca njerëzore dhe vitale e atij kombi.

Kryqi i Kuq e akuzoi dje Izraelin për shkeljen e detyrimeve për t’u ardhur në ndihmë civilëve të plagosur në Rripin e Gazës. Punonjësit e kësaj organizate gjetën katër

fëmijë të traumatizuar pranë trupave pa jetë të nënave të vrara nga një sulm ajror në Zeitun.

Me datë 19 janar, Izraeli dhe Hamasi – i cili ka nën kontroll Rripin e Gazës – deklaruan armëpushim të njëanshëm. Kështu u bë i mundur përfundimi i operacionit trejavor

ushtarak izraelit në Rripin e Gazës, qëllimi i të cilit, sipas shtetit hebre, ishte ndalja e sulmeve me raketa nga ana e forcave Hamas.

Rreth 1300 palestinezë dhe 10 ushtarë izraelitë gjetën vdekjen gjatë ofensivës shkatërruese izraelite në Rripin e Gazës. Vetëm në 22 ditët e konfliktit në Rripin e Gazës, viktimat civile palestineze kanë qenë thuhetse 700. Mes tyre, 410 vetëm fëmijë.

Tre qytetarë izraelitë gjetën vdekjen për shkak të sulmeve me raketa nga ana e Hamasit.

Por analistët thonë se politikanët izraelitë që urdhëruan ofensivën në Gaza e ndërmoren këtë hap mes të tjerash edhe për shkak të afrimit të zgjedhjeve parlamentare të 10 shkurtit, në Izrael.

